

**PERMBAJTJA**

**BASHKIA SHKODER**

**ANALIZA E AKTIVITETIT EKONOMIKO-FINANCIAR  
E VITIT 2014  
DHE PLAN BUXHETI I VITIT 2015**

**PROPOZUAR KESHILLIT BASHKIAK SHKODER, ME  
\_\_/02/2015**

## TABELA E PERBERJES

## Analiza e Aktivitetit Ekonomiko-Financiar e Vitit 2014

	<i>faqe</i>
PAMJE E PERGJITHSHME	3
1. TE ARDHURAT	5
2. SHERBIMET PUBLIKE	10
3. PLANIFIKIMI URBAN	23
4. DREJTORIA SH. SOCIALE, ARSIMIT, KULTURES, SPORTEVE, GRUAS	26
5. DREJTORIA E PROMOVIM ZHVILLIMIT, STATIST. & DREJT. K. P. M. N	36
6. DREJTORIA JURIDIKE DHE ASETIVE	44
7. DREJTORIA ORGANIZIMIT, PERSONELIT, SHERB. MBESHTETESE, PROTOKOLL ARKIVIT DHE INFORMATIZIMIT	46

## Plan Buxheti i Vitit 2014

	<i>faqe</i>
BURIMET E FINANCIMIT	49
1. TE ARDHURAT	50
2. TE ARDHURAT NGA BURIMET KOMBETARE	56
3. KAPITULLI ISHPENZIMEVE	58
4. SHERBIMET PUBLIKE	63
5. DREJTORIA PLANIFIKIMIT DHE KONTR. TE ZHV TE TERRITORIT	78
6. DREJTORIA SH. SOCIALE, ARSIMIT, KULTURES, SPORTEVE, GRUAS	79
7. DREJTORIA E PROMOVIM ZHVILLIMIT, STATIST. & DREJT. K. P. M. N	101
8. DREJTORIA ORGANIZIMIT, PERSONELIT, SHERB. MBESHTETESE, PROTOKOLL ARKIVIT DHE INFORMATIZIMIT	105

**PAMJE E PERGJITHSHME**

Bashkia Shkoder per miratimin e buxhetit te vitit 2015 eshte mbeshtetur ne referencen ligjore te meposhtme:

**I. Ligji Nr. 8652, date 31.07.2000 “Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”**

- *Neni 15:* Percakton parimet mbi te cilat do te behen financimet e njesive te qeverisjes vendore; “ato garantojne autonomine dhe funksionimin e qeverisjes vendore nepermjet njohjes se te drejtes se llojshmerise se burimeve ne formen e tatimeve, taksave, tarifave e te ardhurave te tjera, te transferuara nga pushteti qendror; dhenies se autoritetit per krijimin e te ardhurave per krijimin e te ardhurave ne menyre te pavaruar; dhenien e fondeve te kushtezuara nga qeverisja qendrore ne funksion te kompetencave te deleguara dhe nepermjet dhenies se te drejtes per hartimin, miratimin dhe zbatimin e buxhetit te vet vjetor”.
- *Neni 16:* Te ardhurat e veta te Bashkise ku percaktohen llojet e te ardhurave, baza, kufijte e nivelit te tyre; percaktohen te drejtat e perdorimit te pronave publike, te dhenies se lejeve, autorizimeve, certifikatave si dhe sherbime te tjera ekskluzive lokale.
- *Neni 17:* Percaktohet pjesemarrja lokale ne tatimet kombetare, duke perfshire transferta te kushtezuara dhe te pakushtezuara.
- *Neni 19:* Percakton parimet kryesore per hartimin e buxhetit lokal si: “buxheti te jete gjithmone i balancuar; te perfshije elementet e shpenzimeve dhe te ardhurave; transfertat e kushtezuara te perdoren vetem per qellimin e dhene dhe qe nuk trashegohen ne vitn pasardhes; te ardhurat vendore qe nuk jane te kushtezuara te perdoren per qellime qe percaktohen nga organi vendimmarres dhe trashegohen ne rast se nuk harxhohen; krijimi i fondit rezerve ne masen deri ne 3% te shpenzimeve te planifikuara”.
- *Neni 32:* “detyra me e rendesishme e Keshillit eshte miratimi i buxhetit vjetor si dhe i ndryshimeve dhe amendamenteve gjate vitit mbi buxhetin. Me fuqizimin e autonomies vendore dhe thellimin e metejshe me decentralizimit fiskal, buxheti behet nje instrument i rendesishem qeverises. Keshilli ndjek nga afer gjithe proceduren e pergatitjes, miraton dhe ndjek miratimin e buxhetit nepermjet komisionit te finances”.

**II. Ligji Nr. 9936 Date 26.6.2008 “ Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise ”**

- *Neni 6:* ku thuhet “ Buxheti vendor perfshin te gjitha te ardhuart, shpenzimet dhe financimet e njesise se qeverisjes vendore..... Buxheti vendor eshte i balancuar pervec rasteve kur merrret hua per financimin e projekteve te investimeve.

Buxheti vendor eshte i balancuar ne termat e arketimeve dhe te pagesave. Te gjitha te ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit vendor jane ne terma bruto”.

- *Neni 16:* ku thuhet “Keshilli i njesise se qeverisjes vendore, me vendim te vecante, miraton te ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore per njesite e qeverisjes vendore dhe fondet speciale te tyre, me qellim kryerjen e shpenzimeve per ushtrimin e funksioneve qe kane, si dhe huamarrjen, per financimin e projekteve te investimeve “.
- *Neni 17:* ku thuhet “Kryetari i njesise se qeverisjes vendore propozon drejtimet kryesore te politikës se njesise se qeverisjes vendore dhe projektbuxhetin ne keshillin perkates te njesise se qeverisjes vendore”.
- *Neni 32:* ku thuhet “ Keshilli i qeverisjes vendore brenda dates 31 dhjetor, miraton buxhetin vendor ne baze te vlersimit te te ardhurave dhe te transfertave te pakushtezuara, te percaktuara ne ligjin e buxhetit vjetor”.
- *Neni 44:* ku thuhet: “Per njesite e qeverisjes vendore, kur buxheti miratohet ne nivel programi:
  - rishperndarjet ndermjet programeve miratohen nga keshilli i njesise se qeverisjes vendore;
  - rishperndarjet e projekteve te investimeve, brenda te njejtut program, miratohen nga kryetari i njesise se qeverisjes vendore;
  - rishperndarjet ndermjet zerave te shpenzimeve korrente, brenda te njejtut program, miratohen nga kryetari i njesise se qeverisjes vendore;
  - rishperndarjet brenda te njejtut program dhe zerit te shpenzimeve korrente, ndermjet njesive te ndryshme shpenzuese, miratohen nga nepunesi autorizues i njesise se qeverisjes vendore, nga e cila varet njesia shpenzuese “.

### **III. Ligji Nr. 10296 date 26 .07.2010 “ Per menaxhimin financiar dhe kontrollin”**

- *Kreu II:* Pergjegjeshmeria menaxheriale
- *Kreu III:* Harmonizimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit.



## TE ARDHURAT

Burimet e financimit te qeverisjes vendore perbehen nga:

1. Te ardhurat e veta
  - Taksat vendore, Tarifat, Te ardhura jo tatimore (te tjera, institucione ne varesi te Bashkise), Huate.
2. Te ardhurat nga burime kombetare, qe ndahen ne:
  - Transferta te pakushtezura
  - Transferta te kushtezuara

### TE ARDHURAT E BASHKISE DHE ELEMENTET NDIKUES

Te ardhurat e realizuara nga biznesi zene rreth 54% te te ardhurave te veta te bashkise, ndersa duke perfshire edhe taksen e ndikimit ne infrastrukture, zene 60% te te ardhurave te veta. Per kete arsye eshte e rendesishme per vijueshmerine e mbare te buxhetit te Bashkise Shkoder dhenia e rendesise se duhur dhe trajtimit ne menyre te veçante te ketyre te ardhurave dhe kushteve per mbarevajtjen dhe vjeljen e tyre.

Mbeshtetur nga sistemi i kompjuterizuar i agjentit tatimor Ujesjelles Kanalizime Sh. A., perpunohen dhe administrohen te dhenat per taksapaguesit familjare dhe arketohen taksat dhe tarifate familjare se bashke me tarifate per sherbimin e ujit. Taksat dhe tarifate arketohen ne baze mujore, dhe paguhen ne cdo arke te qytetit te Shkodres.

Eshte aplikuar lehtesia sociale per familjet me kryefamiljare pensioniste, status invaliditeti, me ndihme ekonomike ose jetimi, qe dorezojne dokumentacionin dhe plotesojne kushtet sipas paketes fiskale, duke ndikuar ne zbutjen e problemeve ekonomike te ketyre shtresave.



Te ardhurat nga taksat dhe tarifate familjare kane rezultuar me rritje konstante te arketimeve fale rritjes se vazhdueshme te performances se punes te Nd/Ujesjelles Kanalizime ne rolin e agjentit tatimor, si dhe fale mbeshtjes nga ana e bashkise nepermjet sensibilizimit te institucioneve me punonjes buxhetore dhe bllokimit te sherbimeve te bashkise per debitoret.

Prane Zyres me Nje Ndalese u ofrohet sherbim gjithe bizneseve dhe familjareve tatimpagues mbi informimin dhe rifreskimin me kuadrin ligjor fiskal dhe procedurat e bashkise. Kjo zyre administron edhe maredheniet e kerkese ankesave ne menyre te shpejte dhe efikase, duke nxitur keshtu frymen e hapur dhe bashkepunuese ndaj tatimpaguesve dhe duke ndikuar ne permiresimin e klimes se biznesit ne Shkoder.

Ne zbatimin e kuadrin ligjor, per uljen e evazionit fiskal, rritjen e konkurrences se ndershme, me ndikim te drejtperdrejte ne rritjen e te ardhurave te bashkise jane ndermarre aksione per evidentimin e bizneseve te palicensuara e me adresa dytesore, dhe paralelisht jane monitoruar subjektet biznes i madh per vendodhje te tjera te ushtrimit te aktivitetit. Gjithashtu, per rritjen e te ardhurave si dhe per trajtimin ne menyre te barabarte te te gjithe bizneseve, jane ndjekur masa shtrenguese ligjore per subjektet debitore. Pas njoftimeve dhe ndjekjes se afateve ligjore, jane ndermarre masat shtrenguese te njoftimit dhe bllokim te aktivitetit per rreth 530 subjekte dhe te bllokimit te llogarive bankare dhe hipotekave per rreth 180 subjekte.



Gjate vitit 2014 jane ushtruar rreth 1450 kontrole dhe verifikime prane bizneseve kryesisht ne lidhje me ndryshimet e aktiviteve, siperfaqeve te ndertesave si dhe ne shfrytezimin e hapësirave publike.

Strategjia e rritjes se te ardhurave si nga biznesi ashtu dhe nga familjaret shihet ne shtrirjen e bazes se taksapaguesve dhe ne saktesimin e te dhenave te subjekteve, duke u mbeshtetur edhe nepermjet bashkerendimit te punes me drejtorite paralele te bashkise dhe institucionet te tjera.


Struktura e bizneseve qe ushtrojne aktivitet ne Bashkine Shkoder eshte aktive dhe dinamike, kjo fale politikave dhe strategjive lehtesuese dhe pershpejtuese, qe orientojne tregun e lire ne gjitheshtrirjen e tij.

#### Shperndarja sipas llojit te aktivitetit

- 36 % ushtrojne tregtim artikuj industriale
- 20 % bar – kafe dhe restorante, hoteleri
- 19 % tregti konfeksione
- 15 % ushqimore
- 6 % subjekte prodhimi
- 4 % subjekte ndertimi
- 8 % te tjera



Viti 2014 pati ndryshim te lehte ne favor te raportit te bizneseve te vogla kundrejt biznesit te madh, ku aktualisht eshte 77% e totalit te bizneseve, kundrejt 73% vitin e kaluar.



Sigurimi i burimeve financiare ne funksion te realizimit te misioneve te shumta te Bashkise ndaj qytetareve te saj gjen mbeshtetje tek ardhurat e veta, ku burimet kryesore jane taksat dhe tarifat e bizneseve dhe familjeve.

Synimet kryesore jane fokusuar ne rritjen e bazeve taksapaguese, rritjen e konkurrences se ndershme, goditjen e evazionit fiskal, uljen e numrit te subjekteve debitore, implementimin dhe zbatimin e ligjit dhe ndertimin e marredhenieve te mira me taksapaguesit.

Ne te ardhurat e vitit 2014 kane pasur ndikim faktore te ndryshem, si rritja e sensibilitetit te biznesit per perfshirjen ne

skemen e tatimpaguesve te rregullt, rritja e ndergjegjesimit ne njohjen dhe zbatimin e ligjit, perqendrimi i administrates se bashkise ne detyrat e veta, si dhe bashkepunimi i mire ndersektorial dhe institucional brenda drejtorive te bashkise si dhe jashte saj me institucione te tjera te perfshira.



Zerat qe jane me tejkalim pozitiv realizimi dhe qe ndikojne ne realizimin total te te ardhurave kryesisht tarifat e pastrimit, gjelberimit dhe ndricimit me vlere pozitive krahasuar me vitin e kaluar 27. 575 mije Leke qe burojne nga bizneset dhe nga familjet, taksa e pasurise se paluajtshme me vlere pozitive 15. 035 mije Leke nga bizneset, si dhe te ardhurat nga debitorët e vjeter per taksën e biznesit te vogel te administruar nga bashkia me vlere 3. 791 mije zbusin efektet qe rrjedhin nga renia krahasuar me vitin e kaluar nga disa zera qe ne vetevhte administrohen jashte institucionit te Bashkise Shkoder si me poshte:









Kryesisht eshte krijuar veshtiresi ne realizimin e te ardhurave buxhetore dhe eshte vene re nje renie e theksuar nga realizimi i vitit te meperparshem te taksa e ndikimit ne infrastukture nga pezullimi me Vendim nr 1, dt. 02.08.2014 te Keshillit Kombetar te Territorit te lejeve te reja ndertimore.

Gjithashtu diference ka krijuar edhe tatimi i thjeshtuar i biznesit te vogel qe nga Janari 2014 nuk administrohet me nga pushteti vendor por vilet nga Drejtoria Tatimore Qendrore.

Kane ndikuar edhe taksat per automjetet e perdorura qe vilet nga DRShTRr, taksa e kalimit te drejtes se pronesise qe administrohet nga ZRRPP, tarifa per legalizim dhe urbanizim qe vilej nga Aluizni, zera keto qe ndikohen nga faktore jashte juridiksionit te pushtetit vendor.

Me poshte grafiket e zerave kryesore:





LLOJET E TE ARDHURAVE	Realizimi 2013	Plani 2014	Realizimi 2014
TE ARDHURAT EVETA GJITHSEJ	363.797	373.400	310.554
TE ARDHURAT NGA TAKSA VENDORE	198.306	197.000	166.640
Tatim fitim i thjeshtuar biznes i vogel	68.340	56.300	52.603
<i>Taksa vendore mbi biznesin e vogel (detyrime te kaluara)</i>	-	-	3.791
Taksa e Pasurise se paluajtshme (ndertesa)	32.413	52.800	47.450
<i>nga biznesi</i>	21.068	40.800	34.875
<i>nga familje</i>	11.345	12.000	12.575
Taksa fjetjes ne hotel	524	1.300	448
Taksa ndikimit ne infrastrukture	38.995	40.000	20.886
Taksa kalimit drejtes pronesise	10.947	8.100	9.063
Taksa e rregjis pervitshem mjete transp	36.310	29.000	25.026
Takse zenie hapësira publike	3.589	1.100	894
Takse tabele	340	400	335
Taksa reklame	6.848	8.000	6.144
TE ARDHURA NGA TARIFA VENDORE	110.033	150.500	123.456
Tarife vjetore per pastrimin,heqje mbeturina	62.279	79.600	78.600
<i>nga biznesi</i>	35.280	51.100	48.666
<i>nga familje</i>	26.999	28.500	29.934
Tarife ndricimi	14.401	22.300	21.535
<i>nga biznesi</i>	4.059	10.900	10.098
<i>nga familje</i>	10.342	11.400	11.437
Tarife gjelberimi	10.475	14.300	14.596
<i>nga biznesi</i>	4.618	8.600	8.072
<i>nga familje</i>	5.857	5.700	6.524
Tarife per leje sherbimi veterinar	655	1.300	407
Tarife sherbimi parkim automjete	2.920	3.300	2.077
<i>nga mjetet per biznes</i>	1.077	1.800	765
<i>nga mjetet personale</i>	423	-	-
<i>parking i rezervuar</i>	1.420	1.500	1.312
Tarife licensa transporti	1.035	100	441
Tarife per license karburanti	250	600	500
Tarife sherbimi per Urbanistiken	1.796	1.800	1.103
Tarife per Legalizim,Urbanizim	13.649	24.000	1.153
Tarife sherbimi dublikate arkivi	76	100	38
Tarife sherbimi nga Instituc kult & sport	2.498	3.100	3.005
<i>Biblioteka</i>	-	-	-
<i>Muzeu Historik</i>	1.578	1.500	2.068
<i>Taetri Migjeni</i>	920	1.400	592
<i>Qendra Kulturore Femijeve</i>	-	100	346
<i>Pallati Sportit</i>	-	100	-
TE ARDHURA JOTATIMORE	55.458	25.900	20.458
Te ardhura nga privatizimi	2.921	-	950
Te ardhura nga qera	1.712	700	754
<i>qera lokali</i>	1.381	700	666
<i>qera trualli</i>	331	-	88
Te ardhura nga tendera	-	-	2
Te ardhura nga gjendja civile	75	200	45
Te ardhura nga bursa (shkollat)	262	200	467
Te ardhura nga kopshtet	6.596	9.300	7.614
Te ardhura nga cerdhet	3.702	4.000	3.778
Te ardhura nga kundrvajtje administrative	40.031	11.500	6.733
<i>gjobe per mosshyerje detyrimi ne afate ligjore</i>	4.184	3.500	3.191
<i>gjobe nga kontrole dhe inspektime</i>	290	300	20
<i>gjoba Policia bashkiake</i>	466	1.700	553
<i>gjoba nga Inspektoriati Ndertimit Vendor</i>	35.092	6.000	2.969
Te ardhura nga rojet (kopshte +cerdhe)	135	-	30
Dokumenta strehimi	17	-	17
Te ardhura ngab Institucionet (Komunalja)	7	-	67



## SHERBIMET PUBLIKE

### A- REALIZIMI I SHERBIMEVE PUBLIKE PER VITIN 2014

#### 1. Sherbimi i Pastrimit te Qytetit

Pasqyra e shpenzimeve sipas thesarit per sherbimin e pastrimit te qytetit ne mije leke:

Nr	Emertimi	Plani 2014	Realizimi i 2014
1	Paga	1 806	1 232
2	Sigurime shoqerore	288	206
3	Shpenzime operative	99 045	93 734
4	Kosto depozitimi Landfillin-Bushat	12 455	4 995
<b>SHUMA</b>		<b>113 594</b>	<b>100 167</b>

Shpenzimet per sherbimin e pastrimit ne buxhetin 2014 jane realizuar ne baze te kontrates baze me afat 5-vjeçar, e cila ka hyre ne fuqi me 1 Tetor 2013. Pati vazhdimesi ne sherbimet baze, por gjithashtu edhe permiresim cilesor te termave te aneks-kontratave te vitit 2014 (per zonen jugore dhe veriore). Jane realizuar keto sherbime:

- “Mbledhje e transport mbeturina urbane” u realizua ne te gjithe qytetin. Ky proces pune eshte menaxhuar nga perdorimi i rreth 540 kazaneve, te cilet ne masen 90 % evadohen vetem nje here ne dite ndersa 10 % e ketyre kazanave evadohen 2 here ne dite, kjo ne ato vende qe kane prurje te medha mbetjesh urbane( sic jane tregjet dhe akset kryesore)
- “Menaxhimi i kazanave” eshte kryer duke bere riparimin e herpashershem nga demtimet dhe lyerjen e tyre.
- “Fshirja e rrugeve” e bere mekanike dhe me dore eshte kryer cdo dite sipas siperfaqeve te hartuara ne grafik, ndersa nje pjese e rrugeve e mbingarkuar me aktivite biznesi eshte mirembajtur dhe ditën, per te mbajtur nen kontroll keto zona.
- “Larja e rrugeve” eshte kryer per 200 dite sipas grafikut te larjes se rrugeve 1 here ne dite dhe 2 here ne dite.

#### 1.1. Depozitimi i mbetjeve Urbane ne Landfillin Bushat.

Ka filluar normalisht shfrytezimi i landfillit Bushat ne zbatim te VKB nr. 99, date 01/11/2013 dhe te kontrates baze te realizuar me 27. 08. 2014 “ Per Depozitim te Mbetjeve Urbane”. Ka ngelur pa pagese periudha 01.01.2014 – 30.08.2014 ne vleren 6 690 350 lek.

Kjo per arsye se ne baze te akt-marreveshjes ne kemi vazhduar depozitimimin ne Landfill gjate gjithë kesaj periudhe por nuk kemi patur tarife depozitimi nga Komiteti i Menaxhimit te Integruar te Mbetjeve ( prane Ministrise se Mjedisit ) i cili do percaktonte rregullat e funksionimit, menaxhimin dhe tarifen ne ton te depozitimit. Ne keto kushte, me 27.08.2014 u arrit marreveshja e perbashket dhe u realizua kontrata e bashkepunimit. Pas kesaj kontrate pagesat jane realizuar normalisht me çmimin e rene dakort ndermjet paleve dhe te miratuar me VKB nr 5 te dates 31.01.2014.

Riciklimi tashme ka hapa konkrete meqenese eshte bere i detyrueshem me kontrate me 3% vlere qe zbritet nga kostoja totale e kontrates. Jane caktuar dy pika grumbullimi ne qytet per mbetjet e riciklueshme (kryesisht plastike, karton dhe leter). Jane realizuar fushata dhe aktivitete te shumta sensibilizimi ne shkolla, biznese private dhe institucione shtetore, te cilat ne vetevehte kane shprehur rritje te ndergjegjesimit per kete proces, te selektimit te mbetjeve urbane. Mendojme qe kjo pune duhet te vazhdoje edhe ne te ardhmen, per ti paraprire dhe zbatimit te VKM nr 418 date 25.06.2014 te cilat kane percaktuar afate kohore (vitin 2016) per njesite e qeverisjes vendore, per venien ne eficence te plote te “Grumbullimit te diferencuar te mbetjeve ne burim”.

## ***2. Sherbimi i Mirembajtjes se Siperfaqeve te Gjelberta***

Sherbimi i mirembajtjes se siperfaqeve te gjelberta kryhet me sipermarrije, ne zbatim te kontrates 5-vjeçare te lidhur qe ne Tetor te 2013 dhe aneks-kontratave te hartuara per 2014. Ne preventivat e hartuar per sherbimin e mirembajtjes se siperfaqeve te gjelberta jane kryer keto sherbime:

- Sherbimi i mirembajtjes se lulishteve eshte kryer ne nje siperfaqe prej 66 mije m<sup>2</sup>, ku per cdo 1000 m<sup>2</sup> lulishte perfshihen: bar i kultivuar 450 m<sup>2</sup>, siperfaqe lulesh 250 m<sup>2</sup>, siperfaqe rruge ne lulishte 300 m<sup>2</sup> si dhe mirembajtje drure dekorativ, shkurre dekorative e bordure te gjelberta. Jane kryer sherbimet e plota edhe ne siperfaqet e rikonstruara vitet e fundit, me te gjithë elementet e saj. Perveç tyre ne siperfaqet e tjera te gjelberta qe nuk kane keto elemente jane kryer sherbime te pjesshme ne mirembajtje.
- Mirembajtje e drureve dekorativ, qe perfshin mirembajtjen e drureve dekorativ te gjelberimit rrugor, veç lulishtave. Ne preventivin e hartuar perfshihen proceset e krasitjes se tyre, vaditjes, prashitjes si dhe pleherimit per nje zhvillim sa me te mire. Sipas inventarit rezultojne 4020 drure dekorativ ne rruget kryesore te qytetit.
- Mirembajtja e shkurreve dekorative prej 800 cope perfshin mirembajtjen e shkurreve dekorative nendaresen te rruga “Mehmet Pashë Plaku”.
- Ne zerin “Mbjellja e drureve, shkurreve dhe bordurave te gjelberta” u parashikua dhe u krye zevendesimi i tyre nga tharjet dhe demtimet e pakthyeshme ne lulishta, si dhe plotesimi i gjelberimit rrugor.
- Ne zerin “Mirembajtje siperfaqe ujore” prej 650 m<sup>2</sup> perfshihen punimet e mirembajtjes se shatervanit ne lulishten e Parruces, shatervani Sheshi Demokracia. Punimet qe perfshihen jane pastrimi, larja e tyre cdo muaj, si dhe riparimi i pompave dhe elektropompave ne raste te difekteve.

Ne zerin “Mirembajtje shkurre dekorative” futen 250 cope ne vazo te medha te mbjellura me shkurre. Keto ndodhen kryesisht ne hyrjen e qytetit tone si dhe ne Pedonalen e Piacës. Ne preventiva eshte llogaritur prashitja, vaditja, mirembajtja e vazove si dhe ndonje zevendesim te bimeve te demtuara.

*Pasqyra e shpenzimeve sipas thesarit per sherbimin e mirembajtjes se siperfaqeve te gjelberta ne mije leke*

Nr	Emertimi	Plani 2014	Realizimi 2014
1	Paga	614	518
2	Sigurime shoqerore	98	87
3	Shpenzime operative	27 710	27 600
<b>SHUMA</b>		<b>28 422</b>	<b>28 205</b>

### 3. Sherbimi i Mirembajtjes se Varrezave Publike dhe Deshmoreve

Realizimi i ketij sherbimi kryhet me siper marrje, ne baze te kontrates baze te lidhur me 01. 07. 2013, kontrate 5-vjecare dhe te aneks – kontratave te lidhura per vitin 2014. Eshte kryer ne perputhje me preventivat dhe specifikimet tekniku, ku jane kryer keto sherbime:

- Mirembajte parcela varrezash dhe rrugeve mbrenda tyre.
- Mbjelle bordura te gjelberta ne parcela te reja si dhe druresh dekorativ ne keto parcela.

*Pasqyra e shpenzimeve sipas thesarit per sherbimin e mirembajtjes se varrezave publike dhe deshmoreve ne mije lek*

Nr	Emertim	Plani 2014	Realizimi 2014
1	Paga	128	120
2	Shpenzime shoqerore	21	20
3	Shpenzime operative	6 314	6 314
<b>SHUMA</b>		<b>6 463</b>	<b>6 454</b>

Gjate ketij viti jane realizuar sherbime cilesore sipas zerave te mesipert per Mirembajtjen e Varrezave Publike dhe Deshmoreve, si dhe ruajtjen e tyre.

Gjate ketij viti eshte realizuar shpronësimi i nje siperfaqe rreth 1.2 hektarësh ne te cilen me pas eshte realizuar dhe nje investim i yni me vlere 6.7 milion leke, per te realizuar parcela te reja te cilat permbajne rreth 1600 vende varresh te reja, te cilat kane filluar shrytezimin.

### 4. Mirembajtje Rruge e Trotuare ne Qytet

Ky shërbim realizohet me kontrate 5 vjeçare. Per vitin 2014 është lidhur aneks kontrata prej 7000 mije leke dhe janë realizuar punimet në baze të preventivit të detajuar sipas vleresimit teknik të gjendjes së rrugëve dhe trotuareve. Per vitet e tjera brenda vlerës së përgjithshme të kontratës do të hartohen aneks kontratat në përputhje me vlerësimin e gjendjes teknike në periudhat përkatëse.

*Pasqyra e shpenzimeve sipas thesarit për mirëmbajtje rrugë e trotuare në qytet në mije leke*

Nr	Emertimi i punimeve	Plani 2014	Realizimi 2014
<b>1</b>	Shpenzime operative	7 000	<b>7 000</b>
<b>SHUMA</b>		<b>7 000</b>	<b>7 000</b>

Gjatë vitit 2014 janë realizuar punimet për riparimin e rrugëve me të amortizuara. Në këto raste është nderhyrë në mbylljen e gropave me të gjithë nënshtresat e shtresat asfaltike, si dhe në riveshjen e një pjese të rrugëve të demtuara si shtrese punuese.

Një vëmendje të vecante i është kushtuar edhe riparimit të trotuareve. Kryesisht është nderhyrë në trotualet që kanë qene me amortizim me të madh ose që kanë pesuar demtime ose shembje të tyre.

Po ashtu është punuar në ngritje dhe riparime të pusetave të demtuara në rrugë, si dhe riparimi i kunetave e bordurave.

## 5. Ndrëçim rrugor

*Pasqyra e shpenzimeve për ndrëçimin rrugor në mije leke*

Nr	Emertimi i shpenzimeve	Plani i vitit 2014	Realizimi 2014
<b>600</b>	Paga	2 213	1 845
<b>601</b>	Sigurime shoqërore	352	308
<b>602</b>	Shpenzime operative	43 000	35 164
<b>606</b>	Kompens. punonjësish	36	16
<b>Shuma</b>		<b>45 601</b>	<b>37 333</b>

1. Zerat **Paga** dhe **Sigurime Shoqërore** është realizuar në shumën **1 845 mije** dhe **308 mije** leke.
2. Zeri Shpenzime Operative përbehet nga dy pjesë:
  - a. **Materiale e shërbime speciale.**

Për zerin Materiale e shërbime speciale kanë qene planifikuar për t'u shpenzuar 3 000 000 leke. Ky shpenzim ishte parashikuar për blerjen e materialeve elektrike për **mirëmbajtjen** e infrastruktures së ndrëçimit ekzistues të qytetit me një sipërfaqe prej 531 000 m<sup>2</sup> rrugë, sheshe e

lulishte. Gjithsejt per zerin materiale e sherbime speciale realizimi per vitin 2014 eshte 2 915 mije leke. Jane kryer procedurat deri ne furnizimin e mallit. Me keto shpenzime eshte siguruar baza materiale e nevojshme per mirembajtjen e rrjetit elektrik.

**b. Sherbime** ku perfshihen kryesisht shpenzimet per energjine elektrike.

Per zerin Sherbime, ne te cilat ishin parashikuar shpenzimet per energjine elektrike me shume **40 000 000** leke. Me fondin e programuar eshte realizuar shlyerja e faturave te energjise elektrike deri ne fund te vitit 2014 me vlere **32 249** mije leke. Diferenca ne realizim vjen si rezultat i faturave te kontestuara per te cilet eshte hapur proces gjyqesor.

➤ **Sinjalistike – Dekor**

*Pasqyra e shpenzimeve per sinjalistike - dekor ne mije leke*

Nr.	Emertimi i shpenzimit	Plani i vitit 2014	Realizimi 2014
600	Paga	742	638
601	Sigurime Shoqerore	118	107
602	Shpenzime operative	3 060	2 192
606	Kompen. punonjesish	12	0
<b>Shuma</b>		<b>3 932</b>	<b>2 937</b>

- Zerat **Paga** dhe **Sigurime Shoqerore** Per vitin 2014, kane qene planifikuar respektivisht **742 mije** dhe **118 mije leke**. Realizimi i ketyre dy zerave per vitin 2014 ka qene **638 mije** dhe **107 mije leke**.
- Zeri **Shpenzime Operative**. Per vitin 2014 jane parashikuar **3 060 mije leke** te ndara: ne:
  - Sinjalistike 2 000 mije leke
  - Dekorim qyteti 1 060 mije leke

Gjithsejt per zerin materiale e sherbime speciale "Blerje materiale per sinjalistiken" (horizontale + vertikale) realizimi per vitin 2014 eshte 1 626 600 leke. Jane kryer procedurat dhe me keto shpenzime sigurohet baza materiale e nevojshme per mirembajtjen sinjalistikes horizontale (boje rrugore) dhe sinjalistikes vertikale (tabela te llojeve te ndryshme, tuba etj).

Dekori i qytetit, gjate ketij vitit 2014 realizohet blerja e bredhave per zbukurimin e qytetit per festat e fund vitit me vlere 99 888 leke, gjithashtu dhe blerja e aksesoreve zbukurues me vlere 464 640 leke. Pervec ketyre shpenzimeve per zbukurimin e qytetit jane gjendje dhe aksesoret e blere ne vitet e kaluara qe do te perdoren per kete qellim.

➤ **Mobiliteti (levizshmeria urbane)**

Ne kuader te Levizshmerise (Mobilitetit) te qendrueshme urbane, Bashkia Shkoder ka filluar investime direkte qe ndikojne ne qetesimin e trafikut dhe krijimin e infrastrukturave lehtesuese per perdorimin e biçikletave.

- **Ndertim e rikonstruksion ndertim Sinjalistike Horizontale (bumpe), me vlere 1.536.565 leke**

Jane realizuar 15 bumpe ose kurrize te shtrira te gjera 2, 84 metra, me gjatesi totale prej rreth 200 metra, te vijezuar me sinjalistiken perkatese per kalimin e kembesoreve. Ky lloj bumpi me vija te bardha, qeteson trafikun duke krijuar nje siguri me te larte per kalimtarete qe kapercenje e rruges. Keto bumpe jane vendosur ne pika problematike qe kane paraqitur rrezikshmeri te larte per sigurine e kalimtareve, si dhe prane shkollave dhe institucioneve edukative, per te krijuar nje kalim me te sigurt per femijet dhe nxenesit e shkollave.

- **Vendqendrimet per biçikleta me vlere 1.177.936 leke**

Jane percaktuar dhe realizuar pika parkimi per biçikletat prane institucioneve publike, si dhe ne ambiente te tjera me frekuentim te larte nga njerezit (pedonale, zona baresh, etj) si dhe prane monumenteve. Jane percaktuar tre modele stendash parkimi per biçikleta, duke percaktuar nje dizajn ne baze te vendit ku eshte percaktuar parkimi. Kjo duke iu pershtatur profilit te institucionit, por edhe nga profili i personave qe frekuentojne zonen. Nder insitucionet ku jane vendosur parkimet per biçikleta ia vlen te permenden: Universitetet, teatri, muzete (kalaja), stadiumi, pallati i sportit, zona pedonale, etj.

### ➤ *Transporti Urban*

Gjate vitit 2014 sherbimi i transportit urban ka vazhduar te funksionojte kryesisht ne dy linjat qe kane funksionuar edhe me pare, Bahçallek-Fermentim-Bahçallek dhe Qender-Shiroke-Zogaj e kthim. Nga shtatori i vitit 2012 sherbimi kryhet me operator privat.

Operatori qe kryen kete sherbim, ka plotesuar numrin e nevojshem te automjeteve te planifikuar per kryerjen e ketij sherbimi me cilesi shume te mire duke krijuar kushte te mira per udhetim per te gjitha stinet e vitit.

Drejtoria e sherbimeve publike dhe sektori i transportit ka ushtruar kontrolle te vazhdueshme dhe monitorime per te bere te mundur qe ky sherbim te jete sa me eficient dhe te plotesoje sa me mire kerkesat dhe nevojat e komunitetit si dhe te shohe mundesite e permiresimit te metejshem te ketij sherbimi duke evidentuar edhe nevojat e kerkesat e operatorit qe punon ne kete sherbim.

Bashkia Shkoder ka realizuar sinjalistiken e nevojshme per te mbeshtetur realizimin e qarkullimit normal, si dhe tabelat ne stacione per informacion per oraret e levizjes e te sherbimit, frekuencat etj.

Ne mbeshtetje te VKM Nr. 637 date 21. 05. 2008 per tarifat e transportit urban, Ligjit Nr. 9374 date 21.04.2005 "Per ndihmen shteterore", referuar KNSH (Komisioni i ndihmes shteterore) Nr. 26 date 17.06.2008 "Per ndihmen shteterore ne formen e kompensimit te sherbimeve me interes te pergjithshem ekonomik" Keshilli Bashkiak me Vendimin Nr. 5 date

31. 01. 2014, ka bere te mundur qe per vitin 2014 te behet subvencionimi social per 600 abone ne muaj per nje periudhe 10 mujore gjate vitit.

Ne zbatim te ketij vendimi gjate ketij viti eshte bere subvencionimi vetem per 7 muaj pasi ne muajt korrik – gusht nuk ka qene e parashikuar qe te behet subvencionimi per abonete e nxenesve e studenteve dhe per arsye se zbatimi i VKB Nr. 5 date 31. 01. 2014 ka filluar ne muajin mars 2014.

Subvencionimi ka qene i parashikuar ne vleren 1200 lek per çdo bilete pajtimi njeperdorimeshe, ku vlera e subvencionit ka qene 7 200 mije leke. Per vitin 2014 Bashkia Shkoder ka subvencionuar per 8 muaj operatorin ne vleren 5 760 mije leke.

## **B- INVESTIME PUBLIKE PER VITIN 2014**

### ***Rikualifikimi Urban Blloqe Banimi me vlere 11. 924. 680 mije leke***

Per vitin 2014 eshte parashikuar te kryhet rikualifikimi urban ne 5 blloqe banimi ne qytet.

- **Sistemim blloqe banimi Qafhardhi me vlere 2. 011. 428 leke**

Me fondin e programuar jane realizuar shpenzimet e siper marrjes se zbatimit, te mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve per rikualifikimin e siperfaqeve te shesheve, rrugeve te brendeshme e trotuareve. Punimet kryesore jane kryer ne asfaltimin e rruge te brendeshme te ketij blloku, kanalizimin e ujrave te bardha e trotuare betoni te krehur.

- **Sistemim blloqe banimi Bulevardi Mehmet Pashe Plaku (pallatet parafabrikat) me vlere 2. 439. 485 leke**

Me fondin e programuar jane realizuar shpenzimet e siper marrjes se zbatimit, te mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve per rikualifikimin e siperfaqeve te shesheve, rrugeve te brendshme e trotuareve aty ku ka hapësire. Punimet kryesore jane kryer ne asfaltimin e rruge te brendshme te ketij blloku, kanalizimin e ujrave te bardha e trotuare betoni te krehur, shtimi i siperfaqeve te gjelberta, mbjellje peme e lule dekorative, vendosje stola.

- **Sistemim blloqe banimi ish Parku i Mallrave rruga Gjovalin Gjadri me vlere 2. 170. 288 leke.**

Me fondin e programuar jane realizuar shpenzimet e siper marrjes se zbatimit, te mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve ne rruge te brendeshme, largimin e ujrave te bardha si edhe ndertimi i kunetes dhe konturimi i rrugeve. Ky bllok eshte asfaltuar ne vitin 2013 ne bashkepunim me Komisionin Evropian ne kuader te projektit te KUZ ne Zonen Industriale.

- **Sistemim blloqe banimi rruga Zogu I-re (krahu i djathe ne dalje qyteti Zyra e Punes, -Drejt. e Bujqesise) me vlere 2. 765. 851 leke**

Me fondin e programuar jane realizuar shpenzimet e siper marrjes se zbatimit, te mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve per rikualifikimin e siperfaqeve te shesheve, rrugeve te brendshme, ndertimi i KUB, asfaltimi i rrugeve si dhe krijimi i hapësirave te sherbimit.

- **Sistemim blloqe banimi Xhabijej (krahu i djathe dalje e qytetit) me vlere 2. 037. 850 leke**

Me fondin e programuar jane realizuar shpenzimet e siper marrjes se zbatimit, te mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve per rikualifikimin e siperfaqeve te shesheve, rrugeve

te brendshme e trotuareve aty ku ka hapesire. Punimet kryesore jane sistemimi dhe asfaltimi rrugeve te brendshme, shtimi i sipefaqeve te gjelberta dhe ambienteve te tjera te sherbimit.

- **Rikonstruksion ndriçimi qytet me vlere 5. 312. 928 leke**

- **Rikonstruksion ndriçimi Lulishta Perash me vlere 1. 567. 580 leke.**

Me fondin e programuar eshte parashikuar te mbulohen shpenzimet e sipermarrjes se zbatimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve per ndriçimin e kesaj lulishte. Punimet jane ne vazhdim. Po punohet ne rikonstruksionin e rrjetit elektrik.

- **Rikonstruksion ndriçimi rruge dytesore me vlere 3. 745. 348 leke.**

Me fondin e programuar eshte parashikuar te mbulohen shpenzimet e sipermarrjes se zbatimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve per ndriçimin e rrugeve dytesore, kryesisht ato te rikonstruktura. Per kete objekt kontrata eshte lidhur ne fund te muajit dhjetor 2014 dhe punimet vazhdojne.

- **Ndertim parcela per Varreza Publike me vlere 6. 745. 440 leke.**

Me fondin e programuar jane realizuar shpenzimet e sipermarrjes se zbatimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve per krijimin e parcelave te reja, krijimin e rrugeve te brendshme dhe asfaltimin e tyre si dhe rrethimin me rrjete pengimin e demtoreve.

- **Rikonstruksion i Varrezave te Deshmoreve me vlere 1. 163. 398 leke.**

Me fondin e programuar jane realizuar shpenzimet e sipermarrjes se zbatimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve per rikonstruksionin e varreve te deshmoreve ku punimet kryesore kane qene zevendesimi i pllakave egzistuese me pllaka mermeri si dhe sistemimi i rrugeve te brendshme ne varreza.

### ***Rikonstruksion rruge dytesore***

Per vitin 2014, ashtu si dhe ne vitet e kaluara, u parashikua rikonstruksioni ne rruge dytesore te qytetit, duke marre ne konsiderate propozimet e bera nga njesite administrative (Rajonet) te cilet kane paraqitur prioritetet sipas kerkesave te komunitetit.

- **Rikonstruksion rruga Ali Pash Gucia, Bacej e Mumini me vlere 3. 646. 850 leke**

Me fondin e programuar jane realizuar shpenzimet e sipermarrjes se zbatimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve. Jane realizuar punimet ne vazhdim ne kanalizimin e ujrave te bardha ne rrugen A. Pash Gucia ku do te shkarkojne ujrat e bardha te rrugeve Bacej e Mumini si dhe asfaltimi i ketyre rrugeve.

- **Rikonstruksion rruga Llojej e Serafin Fanko me vlere 7. 659. 816 leke**

Me fondin e programuar eshte realizuar shpenzimet e sipermarrjes se zbatimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve per rikonstruksionin e rruges. Jane kryer punimet ne kanalizimin e ujrave te bardha dhe asfaltim.

- **Rikonstruksion rruga Danja me vlere 3. 357. 188 leke**

Me fondin e programuar jane realizuar shpenzimet e sipermarrjes se zbatimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve per rikonstruksionin e rruges. Jane kryer punimet ne kanalizimin e ujrave te bardha, ujrave te zeza, ujesjelles dhe asfaltim.

- **Rikonstruksion rruga Sarda me vlere 3. 683. 450 leke**

Me fondin e programuar jane realizuar shpenzimet e sipermarrjes se zbatimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve per rikonstruksionin e rruges ku jane kryer punimet ne

kanalizimin e ujrave te bardha, ujrave te zeza, ujesjelles. Gjate zbatimit te punimeve ka pasur probleme ne kuota ne kanalizimet, gje qe ka penguar perfundimin e punimeve.

- **Rikonstruksion rruga Enver Draçini Faza i me vlere 5. 659. 096 leke**

Me fondin e programuar jane realizuar shpenzimet e sipermarrjes se zbatimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve per rikonstruksionin e rruges. Jane kryer punimet ne kanalizimin e ujrave te bardha dhe asfaltim.

- **Rikonstruksion rruga Uruçi me vlere 3. 192. 662 leke**

Me fondin e programuar jane realizuar shpenzimet e sipermarrjes se zbatimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve per rikonstruksionin e rruges. Jane kryer punimet ne kanalizimin e ujrave te bardha dhe asfaltim.

- **Rikonstruksion rruga Dautaj me vlere 1. 042. 025 leke**

Me fondin e programuar eshte parashikuar te mbulohen shpenzimet e sipermarrjes se zbatimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve per rikonstruksionin e rruges. Jane kryer punimet ne kanalizimin e ujrave te bardha dhe asfaltim.

- **Rikonstruksion rruga Anton Mazreku me vlere 4. 042. 569 leke**

Me fondin e programuar jane realizuar shpenzimet e sipermarrjes se zbatimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve per rikonstruksionin e rruges. Jane kryer punimet ne kanalizimin e ujrave te bardha dhe asfaltim.

- **Rikonstruksion rruga Lluaj me vlere 3. 565. 309 leke**

Me fondin e programuar jane realizuar pjeserisht shpenzimet e sipermarrjes se zbatimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve per rikonstruksionin e rruges. Gjate zbatimit te punimeve eshte pare e domosdoshme nga sh. a. U. K. zevendesimi i rrejtit te ujesjellesit ne kete rruge. Jane realizuar punime per rikonstruksionin e ujesjellesit gje qe kerkoj shtyrjen e perfundimit te punimeve. Pas perfundimit te linjes se ujesjellesit kane perfunduar punimet ne kanalizimin e ujrave te bardha dhe shtrimin e rruges.

- **Rikonstruksion rruga Ajasem me vlere 2. 704. 261 leke**

Me fondin e programuar eshte parashikuar te mbulohen shpenzimet e sipermarrjes se zbatimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve per rikonstruksionin e rruges. Jane kryer punimet ne kanalizimin e ujrave te bardha dhe asfaltim.

- **Rikonstruksion rruga Pjeter Gjoka me vlere 2. 269. 582 leke**

Me fondin e programuar jane realizuar shpenzimet e sipermarrjes se zbatimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve per rikonstruksionin e rruges. Jane kryer punimet ne kanalizimin e ujrave te bardha dhe asfaltim.

- **Rikonstruksion rruga Kadukaj me vlere 3. 787. 897 mije leke**

Me fondin e programuar jane realizuar shpenzimet e sipermarrjes se zbatimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve per rikonstruksionin e rruges. Jane kryer punimet ne kanalizimin e ujrave te bardha dhe asfaltim.

- **Rikonstruksion rruga Daijej me vlere 912. 620 leke**

Me fondin e programuar jane realizuar shpenzimet e sipermarrjes se zbatimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve per rikonstruksionin e rruges. Jane kryer punimet ne kanalizimin e ujrave te bardha dhe asfaltim.

- **Rikonstruksion rruga Babej me vlere 1. 974. 621 mije leke**

Me fondin e programuar jane realizuar shpenzimet e siper marrjes se zbatimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve per rikonstruksionin e rruges. Jane kryer punimet ne kanalizimin e ujrave te bardha dhe asfaltim.

- **Rikonstruksion rruga Jorgji Karamitri me vlere 745. 217 mije leke**

Me fondin e programuar jane realizuar shpenzimet e siper marrjes se zbatimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve per rikonstruksionin e rruges. Jane kryer punimet ne kanalizimin e ujrave te bardha dhe asfaltim.

**Me VKB. 36 dt 30. 06. 2014 me rialokime jane realizuar:**

- **Rikonstruksion rruga Pjeter Gjoka Segmenti II me vlere 1. 909. 090 leke**

Me fondin e programuar jane realizuar shpenzimet e siper marrjes se zbatimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve per rikonstruksionin e rruges. Jane kryer punimet ne kanalizimin e ujrave te bardha dhe asfaltim.

- **Ndertim KUB rruga Destani me vlere 549. 636 leke**

Me fondin e programuar jane kryer punimet ne kanalizimin e ujrave te bardha dhe nivelimi i rruges me stabilizant.

**Me VKB 48 dt 29. 09. 2014 me rialokime jane realizuar:**

- **Ndertim Lulishtja Pazar me vlere 480. 000 leke**

Jane vendosur bordura, mbjelle peme, bar dhe shkurre dekorative.

- **Mbjedhje peme dekorative 1. 500. 000 leke**

Eshte realizuar plotesimi me 120 peme dekorative i akseve kryesore ne pershtajte me llojin e pemeve ekzistuese.

- **Rikonstruksion godina e azilit te pleqve 2. 307. 042**

Eshte lidhur kontrata ne mesin e muajit dhjetor. Punimet vazhdojne. Do te realizohen punimet per rikonstruksionin e çatise, lysterjen e brendhsme dhe te jashtme te objektit.

***Rikonsatraksione te tjera ne rruge***

- **Ndertim e rikonstruksion trotuare, ndertim Sinjalistike Horizontale (bumpe), me vlere 1. 536. 565 leke**

Me fondin e programuar jane realizuar shpenzimet e siper marrjes se zbatimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve per ndertimin e sinjalistikes horizontale (bumpave) ne rruget e qytetit per te rritur sigurine e qarkullimit. Kjo sinjalistike u vendos ne rruget kryesore prane shkollave, kopeshteve e zonave me qarkullim me te dendur si dhe me rrezikshmeri te konsiderueshme ne kapercimin e rruges. Jane vendosur gjithsej 15 cope bumpe.

***Vend qendrim per Bicikleta me vlere 1. 177. 936 leke***

Kontrata per kryerjen e punimeve ne kete objekt eshte lidhur ne fund te muajit dhjetor 2014. Do te realizohet vendosja e disa vendqendrimeve per bicikleta prane institucioneve te ndryshme publike, parqeve, tregjeve, si dhe ne rruget kryesore te qytetit.

***Rikonstruksion pallati sportit "Qazim Dervishi" me vlere 4. 748. 897 mije leke***

Me fondin e programuar u parashikua realizimi shpenzimet e siper marrjes se zbatimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve per rikonstruksionin e ambienteve te sherbimit e sanitare. Gjithashtu u realizua dhe shtrimi i fushes me parket te ri. Por menjehere ne kete parket u shfaqen probleme te medha. Punimet per rishtrimin e parketit vazhdojne.

#### ***Sistemim i ambienteve te jashtme Shkolla Shiroke me vlere 5. 064. 380 leke***

Me fondin e programuar eshte parashikuar te mbulohen shpenzimet e siper marrjes se zbatimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve per Sistemimin e jashtem te Shkolles Shiroke, ndertimin e shkalleve, platformes hyrese, murit rrethues si edhe tubacioneve per shkarkimin e ujrave, si dhe shpimi i pusit per sigurimin e ujit te pijshem, per te cilin punimet po vazhdojne Jane realizuar te gjitha punimet e tjera, por nuk eshte bere financimi i vleres deri 31. 12. 2014.

### **C- BASHKEFINANCIME**

Ne bashkefinansim me Fondin Shqiptaro-Amerikan te Zhvillimit per vitin 2014 u alokua nga fondet e veta shuma **6. 000 mije leke** per objektin **Restaurim fasada rruga 13 Dhjetori e 28 Nentori**, mbeshtetur ne Marreveshjen e firmosur ndermjet ketij fondacioni dhe Bashkise Shkoder miratuar kjo me Vendim te Keshillit te Ministrave nr 918 date 4. 10. 2013. Per kete objekt eshte realizuar procedura e prokurimit eshte lidhur kontrata dhe kane filluar punimet.

- **Bloku i Pallateve Vau Dejes nga fondi i zhvillimit te rajoneve me vlere 28. 790. 814 leke**

Kjo nderhyrje eshte realizuar nga fondi i zhvillimit te rajoneve. Jane realizuar punimet per rikonstruksion e 11 rrugeve me gjatesi lineare 1800 m, ku eshte bere rindertimi i KUB. KUZ dhe asfaltimi i plote perfshire dhe shtrimi i trotuareve. Eshte rikonstruktuar plotesisht nje bllok banimi ne rrjetin e KUZ, KUB, ndricim dhe gjelberim.

#### ***Nderhyrje gjate aksit rrugor “Ura e Bunes – Shiroke”***

- **Zgjerim Rruga “Ura e Bunes – Shiroke” me vlere 140. 000. 000 leke me financim nga Fondi Shqipetar i Zhvillimit.**

Eshte zgjeruar rruga ekzistuese, permiresuar traseja e saj, jane ndertuar veprat e artit si tombino edhe punimet ne kanalizimin e ujrave te bardha te rruges, eshte ndertuar trotuari per kembesore dhe bicikleta. Pjese e ketij projekti eshte edhe permiresimi i Lulishtes ne Qender te Shirokes, per te cilin punimet jane ne vazhdim.

#### ***Zbatimi i projekteve ne bashkepunim me RDP per Shqiperine e Veriut***

- **Pastrimi i brigjeve te lumit Buna nga Qendra Oblike deri tek ura e Bunes dhe pergjate bregut perendimor te liqenit te Shkodres.**

Ne kuader te ketij aktiviteti jane pastruar nga mbetjet e ndryshme rreth 62 800 m2 siperfaqe e bregut te lumit Buna dhe bregut perendimor te liqenit.

- **Vendosje kazana mbetjesh urbane**

Jane blere dhe priten te instalohen pergjate bregut te liqenit dhe lumit Buna ne momentin e perfundimit te rruges se Shirokes , ( e cila po rikonstruktohet ) sipas nje plani te detajuar, 26 kontenier 1100 litersh dhe 36 kosha mbeturinash 20 litersh.

- **Ndertimi i Sistemit te ndriçimit te rruges Ura e Bunes-Shiroke.**

Investimi i parashikuar per punimet ne Zgjerimin e rruges “ Ura e Bunes-Shiroke”, nuk parashikonte investim ne ndriçimin e plote te kesaj rruge. Bashkia Shkoder ne kuader te Programit Zhvillimi Rajonal i Shqiperise se Veriut (RDP), ka fituar projektin per “Ndertimi i sistemit te ndriçimit i rruges “Ura e Bunes – Shiroke” me vlefte prej 109, 493. 23 Euro te bashkefinancuar me RDP. Gjate vitit 2014 eshte realizuar 90 % e punimeve te parashikuara. Jane instaluar shtyllat dhe ndriçuesat pergjate rruges Ura e Bunes – Shiroke, mbetet per tu kryer dhe lidhja me energjine elektrike.

#### D- INVESTIME NGA DONATORE PER VITIN 2014

##### *Projekti “Furnizimi me Uje dhe Mbrojtja Mjedisore e Liqenit te Shkodres”*

Gjate vitit 2014 ka vijuar zbatimi i projektit “Furnizimi me Uje dhe Mbrojtja Mjedisore e Liqenit te Shkodres” ne lidhje me rehabilitimin e nje pjese te rrjetit te shperndarjes se ujesjellesit dhe kanalizimeve te ujrave te zeza. Ky projekt eshte bashkefinansim i tre donatoreve te huaj dhe e Qeverise Shqiptare.

KFW	-	7.5 mil. Euro (Grant)
SECO	-	7.5 mil. Euro (Grant)
ADA	-	1.9 mil. Euro (Grant)
Qeveria Shqiptare	-	0.5 mil. Euro (Grant)

##### **Aktivitetet e projektit:**

- 1. Komponenti A - (Projektim i detajuar)** Realizuar gjate vitit 2010
  - Projektimi e detajuar me vleresimin e azhornuar te kostove
  - Pregatitja e Dokumentave te tenderit
  - Akordim i dy kontratave per zbatim
- 2. Komponenti C – (Fuqizimi Institucional)** Realizuar gjate vitit 2010-2011
  - Realizimi i blerjes se pajisjeve dhe programeve.
  - Realizimi i trajnimeve te stafit te ndermarrjes.

Te gjitha programet jane perfituar dhe zbatohen ne punen e perditshme nga Stafi i ndermarrjes.
- 3. Komponenti B - (Furnizim dhe ndertim)** Per zbatim gjate vitit 2011-2014
 

Komponenti B konsiston ne 5 kontratat e zbatimit si me poshte:

  - Kontrata 1 – “Furnizimi i pajisjeve te pastrimit te K. U. Z “. (Realizuar)
  - Kontrata 2 – “Shkeputja e K. U. B. nga K. U. Z” (Realizuar)
  - Kontrata 3 – “Ujesjelles dhe K. U. Z. Shkoder” (Realizuar)
  - Kontrata 4 – “K. U. Z. dhe I. T. U. Z. Shkoder” (Ne proces kolaudimi)
  - Kontrata 5 – “Furnizimi dhe instalimi i 15. 500 cope Matesave te ujit”

**Objektet e realizuara deri ne vitin 2014****- Ne sektorin e Ujerave te Zeza**

1. Furnizimi me mjete te specializuara per pastrimin e Ujerave te Perdorura
2. Ndertim i rrjetit te KUZ ne fshatin Shiroke.
3. Ndertimi i rrjetit te KUZ ne fushen e puseve te ujit te pijshem ne Dobraç.
4. Ndertimi i Impiantit te trajtimit te ujerave te zeza.
5. Rehabilitimi i nje pjese te rrjetit KUZ ne qytetin e Shkodres.
6. Rehabilitim i Stacionit te pompimit te ujerave te zeza te qytetit.

**- Ne sektorin e Ujesjellesit**

1. Rehabilitimi i linjes kryesore te dergimit, punimet ne keto objekte vazhdojne.
2. Instalimi i ujematesave te medhenj.
3. Ndertimi i rezervuarit te ndermjetem te stacioni i pompimit te ujit te pijshem.
4. Rehabilitim i pjesshem i rrjetit te shperndarjes se ujit te pijshem (rrjet primar, sekondar dhe tercial)
5. Instalimi i matesave tek klientet familjare.

Eshte rehabilituar rreth 21% e rrjetit te ujesjellesit, me linja kryesore, sekondare dhe terciare. Eshte nderhyre ne rehabilitimin e rreth 20% te rrjetit te kanalizimeve te ujrave te perdorura (rrjet kryesor, sekondar dhe tercial).

**DREJTORIA PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TE  
ZHVILLIMIT TE TERRITORIT**

Kjo analize prezanton zhvillimet e bera ne territorin e Bashkise Shkoder, si edhe punen dhe rezultatet e Bashkise Shkoder ne permbushjen e objektiveve te saj ne fushen e Zhvillimit dhe Kontrollit te Territorit.

Zhvillimet ne Territorin e Bashkise Shkoder per vitin 2014 mbeshteten ne Ligjin nr 10119 date 23. 04. 2009 “ Per Planifikimin e territorit” i ndryshuar, Vendimit te Keshillit te Ministrave nr 502 date 13. 07. 2011 “ Per miratimin e rregullores uniforme te kontrollit dhe zhvillimit te territorit “ ( i ndryshuar), Vendimit te Keshillit Kombetar te Territorit nr 14 date 04. 07. 2013 per „ Miratimin e Instrumentave te Pergjithshem Vendor te Bashkise Shkoder, ne Ligjin nr 107/2014 „ Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit“, Vendimet e Keshillit Kombetar te Territorit nr 1 date 22. 08. 2014, nr 8 date 07. 11. 2014 dhe nr 5 date 29. 12. 2014.

Zhvillimet ne Territor gjate periudhes qe raportohet kane qene zhvillime te planifikuara ne Instrumentin e Planifikimit te Territorit. Zhvillimet ne Territor jane kryer nga Zhvillues private dhe Zhvillues publike. Ne rastin e Zhvillimeve te kryera nga zhvilluesit publike hyjne te gjitha investimet e kryera nga Buxheti Lokal dhe ato te kryera nga Buxheti i Shtetit.

Zhvillimet qe jane kryer nga zhvillues private kapin nje vlere investimi rreth 300. 000 mije leke, ndersa vlere e investimit te kryer nga Buxheti Lokal me vlere 150. 000 mije leke dhe Fondi i Zhvillimit te Rajoneve 38. 000 mije leke.

Pra vlere e investimit privat ne zhvillimin e territorit eshte rreth 2 here me e madhe se ajo publike.

Konkretisht gjate vitit 2014, pra nga janari dhe deri ne 22 gusht 2014, date ne te cilen Keshilli Kombetar i Territorit, bllokoi te gjitha Lejet Zhvillimore, nga ana e Drejtorise sone u pergatiten dhe u zbardhen 28 Leje Zhvillimore Ndertimi, 4 prej te cilave per objektet publike te Bashkise Shkoder, dhe 24 nga Zhvillues private. Keto zhvillime jane dhene ne zona te konsoliduara urbane dhe ne zerin kadastral truall. Zhvillimet kane qene objekte private 1 deri ne 3 kate, 3 zhvillime per adoptime banesash ne njesi sherbimi si, 1 pike karburanti ( unaza lindore e qytetit), 1 rikonstrukcion magazine ne Zonen industriale.

Vendimet e Keshillit Kombetar te Territorit nr 5 date 18. 10. 2013 dhe me pas Vendimi nr 1 date 22. 08. 2014 “ Per harmonizimin e instrumentave te planifikimit vendor ne funksion te ndarjes se re administrative- territoriale” bene qe duke filluar nga kjo date te mos jepej asnje Leje Zhvillimore Ndertimi, duke lejuar vetem leje per punime te infrastruktures dhe ato me karakter publik.

Si rrjedhim planifikimi i bere per realizimin e taksess se ndikimit ne infrastrukture ne masen 40. 000 mije lek nuk u realizua. Realizimi per vitin 2014 eshte 20. 886 mije leke pra 50%.

Pjese e detyrimit ligjor eshte edhe dhenia e lejeve te shfrytezimit ( certifikata e perdorimit) per objektet te cilat kane perfundura dhe jane kolauduar. Gjate vitit buxhetor 2014 jane perpunuar dhe derguar per regjistrim ne zyren e regjistrimit te pasurive te

palujtshme rreth 40 objekte. Prej te cilave 6 objekte multifamiljare, 1 shkolle e re “ At Pjeter Meshkalla”, 1 fabrike e perpunimit te qumeshtit dhe 32 objekte - banesa njefamiljare.

Gjate vitit 2014 jane perpunuar ne total rreth 402 shkresa zyrtare prej te cilave 247 korespondence me institucione publike, dhe 155 pergjigje me qytetaret.

Pjese e punes ka qene edhe hartimi i projekt-preventivave per investimet publike te realizuara me fonde te buxhetit lokal.

Ne kuader te prioriteteve te investimeve te miratuara ne Keshillin e Bashkise sipas Programeve Zhvillimore, Drejtoria e jone ne bashkepunim me drejtorite e tjera ka hartuar dhe percjelle prane institucioneve te tjera, ministrive te linjes, Keshillit te Ministrave, Fondit Shqiptar te Zhvillimit dhe agjensive te tjera financuese rreth 30 projekte dhe projektide ne fushen e infrastruktures, arsimit, sportit, kultures etj.

## **INSPEKTORIATI NDERTIMOR URBANISTIK VENDOR**

Ne zbatim te ligjit 9780, dt, 16.07.2007 “.Per Inspektimin e Ndertimit”si dhe te Ligjit. Nr 8402 dt 10. 09. 1998, ”Per Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve ne Ndertim”i ndryshuar Inspektoriati ndertimor urbanistik vendor, ka organizuar punen e tij.

Gjate vitit 2014, Inspektoriati ndertimor ka ndermarre nje sere nderhyrjesh per prishjen e nje numri te konsiderueshem objektesh te ndryshme, kryesisht per ti hapur rruge investimeve te ndryshme publike te bera nga Bashkia Shkoder, si dhe nga donatore te ndryshem. Keto nderhyrje te Inspektoriatit sherbejne kryesisht per te liruar sa me shume hapësira publike per komunitetin dhe per ti hapur rruge zhvillimit te metejshem te infrastruktures se qytetit.

Megjithe veshtiresite e hasura gjate ushtrimit te detyres, duke pasur parasysh se qyteti ka nje shtrirje te madhe, dhe eshte nje qytet ne zhvillim sidomos ne fushen e ndertimit, nga ana e Inspektoriatit i eshte kushtuar nje vemendje e vecante fenomenit te parandalimit te ndertimeve ne fazat fillestare, si dhe kontrollit dhe disiplinimit te firmave te cilat operojne ne qytetin tone dhe jane pajisur me leje nga ana e Bashkise. Ne disa raste jane marre dhe masa Administrative ndaj ketyre subjekteve ndertuese.

### **Bashkepunimi:**

Persa i perket bashkepunimit nga ana e Inspektoriatit eshte bashkepunuar mire dhe ne menyre korrekte me njesite Administrative te bashkise Shkoder, kemi organizuar takime te herpashershme, me qellim marrjen e informacionit per parandalimin e ndertimeve pa leje.

Bashkepunimi me Inspektoriatin Ndertimor Urbanistik Kombetar. Nga ana jone eshte mbajtur korrespondenca me I. N. U. K per shumicen e praktikave te kryera nga I. N. U. V Bashkia Shkoder, me gjykatën Administrative.

Me Drejtorine e Planifikimit dhe kontrollit te Zhvillimit te Territorit, eshte bashkepunuar mire sidomos ne kontrollin e objekteve te pajisura me leje ndertimi, per zbatimin korrekt te ketyre projekteve.

Nje bashkepunim te mire kemi pasur dhe me Prokurorin e Rrethit Gjyqesor Shkoder. nga ana jone per vitin 2014 jane regjistruar 11 (njembedhjete ) kallzime penale prane kesaj Prokurorie.

Bashkepunimi me Policine e Shtetit. Nga ana e Komisarariatit te Policise ka qene nje bashkepunim shume korrekte, duke na siguruar nje mbeshteje shume te mire ne te gjitha rastet e ekzekutimit te Vendimeve.

### **Pershkrimi i punes, treguesit, Statistikat dhe veshtiresite.**

Prane Inspektoriatit tone per gjate gjithë vitit 2014 ka pasur nje sere ankesash nga qytetare te ndryshem si dhe nga Institucione te ndryshme, nga ana jone jane verifikuar dhe jane kthyer 29 pergjigje qytetareve te ndryshem.

Gjate vitit 2014 Inspektoriati ka bere nje sere nderhyrjesh (prishje objektesh) per lirim e disa rrugeve dhe shesheve ne territorin e Bashkise per ti hapur rruge investimeve publike te bera kryesisht nga Bashkia Shkoder.

Persa i perket veshtiresive, theksojme se megjithë numerin e vogel te punonjesve qe ka Inspektoriati ndertimor, (konkretisht ka vetem dy inspektore, dhe nje Kryeinspektor) e bejne te veshtire punen e Inspektoriatit per te ushtruar kontrollin e plote ne te gjithë territorin e Qytetit.

### **Treguesit dhe statistikat, Vendime te nxjerra dhe te zbatuara**

Nga ana e Inspektoriatit i eshte kushtuar nje vemendje kontrollit te subjekteve ndertuese qe operojne ne qytetin tone, jane ushtruar kontrole dhe sipas rasteve jane marre masa per pezullimin e punimeve ne objekt, si dhe jane vendosur sanksione administrative aty ku jane verejtur shkelje.

Vendimet e dala	Nr	Zbatuar	Objekte te prishura
<b>Vendime prishje te K/insp</b>	4	4	4
<b>Vendime te K. RR. T.</b>	37	37	37
<b>Vendime pezullimi</b>	11	11	
<b>Vendime per dhenie gjobe</b>	<b>11</b>	<b>11</b>	

Vlera e masave Administrative te vendosura eshte 1. 480 mije leke. Nga keto jane arketuar 630 mije leke. Masa e tjera qe nuk jane paguar jane derguar prane sherbimit permbarimor ose jane ne proces gjyqesore.



## DREJTORIA SHERBIMEVE SOCIALE, ARSIMIT, KULTURES, SPORTEVE, GRUAS

### I. Zyra e Arsimit

Realizimi per vtin 2014 per kete zyre paraqitet si me poshte

000/leke

NR	Emertimi	Plan 2014	Realizimi 2014
1	Paga	26 942	24 863
2	Sigurime	4 526	4 368
3	Madhra dhe sherbime	37 661	32 454
4	Transferte korrente te brendeshme	2 520	2 308
5	Transferta ne buxhet familjare	1 540	1 530
6	Investime	2 888	2 506
Shuma		<b>76 077</b>	<b>68 029</b>

#### A. Madhra dhe sherbime

000/ leke

Nr	Emertimi	Plan 2014	Realizimi 2014
1	Materiale dhe sherb. zyre te pergjitheshme	10	0
2	Materile dhe sherbime speciale	11 840	6 912
3	Sherbim me te trete	19 151	20 120
4	Shpenzime transporti	220	184
6	Mirembajtje e zakonshme	3 190	2 078
7	Shpenzime te tjera operative	3 250	3 160
Shuma		<b>37 661</b>	<b>32 454</b>

**Shpenzimet per materiale dhe sherbime speciale, shuma 6 912 mije leke, jane realizuar si me poshte:**

Veshje per festivalin e femijeve ne shumen 289 mije leke, punime skene per festivalin e kenges per femije shuma 686 mije leke, blerje materiale te ndryshme elektrike ne shumen 165 mije leke, blerje materiale te ndryshme hidraulike ne shumen 198 mije leke, blerje ene kuzhine ne shumen 68 mije leke, blerje xham ne shumen 187 mije leke, blerje bojra te ndryshme per lysterje te institucioneve ne shumen 83 mije leke, rimbushje fikse zjarri ne shumen 82 mije leke, blerje peshqire etj ne shumen 92 mije leke, blerje te ndryshme 200 mije dhe shpenzime per ushqime ne shumen 4862 mije leke.

**Ne sherbimet me te trete jane kryer si me poshte: 20 120 shuma mije leke**

Shpenzime per energji elektrike ne shumen 7650 mije leke, shpenzime konsum uji ne shumen 10289 mije leke, shpenzime telefonise ne shumen 394 mije leke, shpenzime per lende djegese ( dru zjarri ) ne shumen 1599 mije leke, shpenzime per printime ne shumen 110 mije leke, shpenzime te tjera ( dizinfektim, etj) ne shumen 71 mije leke dhe shpenzime per sherbim postar ne shumen 7 mije leke.

**Shpenzime per transportin ne shumen 184 mije leke dhe konkretisht:**

Blerie pjese kembimi ne shumen 62 mije leke, shpenzime per siguracion ne shumen 49 mije leke dhe shpenzime te ndryshme ne shumen 73 mije leke.

#### **Shpenzime per mirembajtje: shuma 2 078 mije leke.**

Riparime dysHEME dhe te ndryshme shkolla “Deshmoret e Prishtines “ ne shumen 299 mije leke, riparime te ndryshme kopeshti “ I. S. Brucaj “ ne shumen 188 mije leke, riparime hidroizolimi e te tjera kopeshti “ 1 Qershori “ ne shumen 202 mije leke, riparime dyer e te tjera shkolla “ I. Qemali “ne shumen 146 mije leke, riparime banjo e kanalizime, shkolla Teknologjike ne shumen 168 mije leke, riparime e bojatisje kuzhina e konviktit “S. Spahiu “ ne shumen 129 mije leke, riparime shkolla speciale “ 3 Dhjetori “ ne shumen 68 mije leke, riparime te ndryshme per mure tavane e tarace te konvikti i shkolles Industriale ne shumen 108 mije leke, Iyerje e pjeseshme kopeshti “ T. Alimhilli “ ne shumen 144 mije leke, riparime nyje hidrosanitare kopeshti “ B. Tusha” ne shumen 120 mije leke, riparime per automjete ne shumen 54 mije leke, riparime te paisjeve shkollore (tryeza, karrige etj ) ne shumen 116 mije leke, riparime shkolla M. Camaj ne shumen 156 mije leke dhe riparim shkolla K. Idromeno 180 mije leke

#### **Shpenzime te tjera operative: shuma 3 160 mije leke**

Jane perfshire shpenzimet per siguracione ndertesash ne shumen 468 mije leke, shpenzime per honorare per aktivite te Qendres Kulturore te Femijeve per aktivitetin “Bilbilat e vegjel Kendojne” shuma 510 mije leke, veprimtari sportive dhe shkencore etj shuma 259 mije leke, festa e fundvitit per femije ne shumen 684 mije leke, shpenzime ndricimi per skenen e festivalit shuma 392 mije leke, shpenzime akomodimi te pjesmarresve ne festival ( ushqim dhe veshje ) shuma 687 mije leke dhe fonia e aktivitetit “Bilbilat e vegjel kendojne “ ne shumen 160 mije leke.

#### **Transferta korrente te brendeshme: shuma 2 308 mije leke**

Transferimi per Festivalin Mbarkombetare te Kenges per femije ( krijimtari, çmime, juri ) ne shumen 2 308 mije leke.

#### **Zerin Investime: shuma 2 506 mije leke.**

Rikonstruksion shkolla 9 vjecare “ M. Logoreci” ( ambjente te ndryshme) ne shumen 758 mije leke, rikonstruksion shkolla 9 vjecare” A. Hajdari “( hidroizolim e te tjera ambjente ), ne shumen 633 mije leke, rikonstruksion shkolla” Ndoc Mazi “( banjo e fasade etj) ne shumen 577 mije leke, blerje orendi paisje ne shumen 264 mije leke dhe blerje paisje operacionale ne shumen 274 mije leke.

## **II. DEGA EKONOMIKE KULTURES DHE AKTIVITETET E BASHKISE**

<b>NR</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Plan 2014</b>	<b>Realizimi 2014</b>
1	Paga	15 704	13 423
2	Sigurime	2617	2242
3	Mallra dhe sherbime	13671	11144
5	Transferta te brendshme	5420	5299
6	Transferta ne buxhet familjare	191	179
7	Investime	3595	740
	<b>Shuma</b>	<b>41198</b>	<b>33027</b>

Trajton te gjitha marredheniet financiare te institucioneve kulturore te varesise qe jane: Muzeu Historik, Biblioteka Marin, Barleti, Galeria e Arteve dhe Qendra Kulturore "P. Gaci". Gjithashtu kjo dege ka trajtuar financiarisht edhe shpenzimet per aktivitete te ndryshme social – kulturore te planifikuara nga Zyra e Kultures si dhe shpenzime te tjera per aktivitete te ndryshme ( shtese) te miratuara gjate vitit me VKB.

**a. Muzeu Historik**

000/leke

NR	Emertimi	Plan 2014	Realizimi 2014
1	Paga	5 778	4 437
2	Sigurime	965	741
3	Mallra dhe sherbime	1 063	646
5	Transferta ne buxhet familjare	12	0
6	Investime	200	0
<b>Shuma</b>		<b>8 018</b>	<b>5 824</b>

**Shpenzimet per mallra e sherbime** jane realizuar si me poshte: energji elektrike 133 mije leke, uje 40 mije leke, telefon 83 mije leke, sherbim per ruajtje muzeu 270 mije leke, printime publikime 78 mije, ndersa shpenzime per materiale zyre eshte realizuar ne shumen 42 mije leke. Shpenzime per investime nuk eshte realizuar.

**b. Biblioteka**

000/leke

NR	Emertimi	Plan 2014	Realizimi 2014
1	Paga	6 358	5 812
2	Sigurime	1 075	971
3	Mallra dhe sherbime	1 365	362
5	Transferta ne buxhet familjare	79	79
6	Investime	2 295	178
<b>Shuma</b>		<b>11 172</b>	<b>7 402</b>

**Shpenzimet per mallra e sherbime** jane realizuar si poshte: energji elektrike 108 mije leke, uje 39 mije leke, telefon 75 mije leke, interneti salles 84 mije leke, 6 mije leke materiale dhe sherbime zyre, 10 mije leke materiale speciale, ( per aktivitete), dhe 40 mije leke honorare per aktivitete gjate vitit.

**Shpenzimet per Investime** jane realizuar ne shumen prej 130 mije leke blerje librash dhe 48 mije leke, vendosje e sistemit te kamerave te sigurise.

**c. Galeria Arteve**

000/leke

NR	Emertimi	Plan 2014	Realizimi 2014
1	Paga	1 197	1 111
2	Sigurime	200	186
3	Mallra dhe sherbime	1 525	924
4	Investime	300	0
<b>Shuma</b>		<b>3 222</b>	<b>2 221</b>

**Zeri mallra e sherbime** eshte realizuar si me poshte: Shpenzime per energji elektrike 79 mije leke, uje 23 mije leke, 75 telefon mije leke, shpenzime per katalogun 148 mije leke, shpenzime transporti 46 mije leke, shpenzime per mirembajtje te zakonshme jane shpenzuar 97 mije leke, shpenzime per honorare per aktivitete 300 mije leke, shpenzime per sherbime te tjera operative 156 mije leke. Shpenzime per investime nuk eshte realizuar.

**d. d- Qendra Kultures “ P. Gaci”**

000/leke

NR	Emertimi	Plan 2014	Realizimi 2014
1	Paga	2 371	2 063
2	Sigurime	377	344
3	Mallra dhe sherbime	5 918	5 487
6	Investime	800	562
<b>Shuma</b>		<b>9 466</b>	<b>8 456</b>

**Zeri mallra e sherbime** eshte realizuar si me poshte: Shpenzime per energji elektrike shuma prej 57 mije leke, uje 23 mije leke, telefon 75 mije leke, shpenzime transportit 198 mije leke. Ndersa shpenzime operative ( honorare), ne total jane shpenzuar 4 949 mije leke te ndara:

- Honorare per aktivitetet e ketij institucioni ne shumen prej 941 mije leke
- Honoraret per Orkestren Frymore te Qytetit ne shumen prej 4 008 mije leke

Shpenzime te tjera operative ne shumen prej 185 mije leke.

- **Zeri investime** realizuar ne shumen 312 mije leke blerje kostumesh kombetare dhe 250 mije leke, blerje pianoforte studio.

**II. AKTIVITETE TE ZYRES KULTURES**

000/leke

NR	Emertimi	Plan 2014	Realizimi 2014
1	Mallra dhe sherbime	3 800	3 725
2	Transferta korente te brendeshme	5 420	5 299
3	Transferta te individe	100	100
<b>TOTALI</b>		<b>9 320</b>	<b>9 124</b>

**Aktiviteti „ Karvan Karneval“** - u realizua ne shumen prej 1 495 mije leke

**Aktiviteti 8 Marsi –Dita e Gruas** – realizuar ne shumen prej 100 mije leke.

**Aktiviteti“ 2 Prilli“** – realizuar ne shumen prej 298 mije leke

**Aktiviteti –Dita e Romeve** - realizuar ne shumen prej 80 mije leke

**Aktiviteti 6 Maji Dita e luleve.** – realizuar ne shumen prej 590 mije leke

**Aktiviteti Koncerti “Tre Tenoret “**- realizuar ne shumen prej 900 leke

**Aktiviteti “Festivali i muzikes moderne“** - realizuar ne shumen prej 595 mije leke

**Aktiviteti “Dita e Liqenit”** – realizuar ne shumen prej 295 mije leke

**Aktiviteti “ Koncertet e veres “** –u realizua ne shumen prej 295 mije leke

**Aktiviteti - Ditët e trashigimise kulturore-** realizuar ne shumen prej 200 mije leke

**Aktiviteti “ Dita e lumturimit te Nane Terezes “.** – realizuar ne shumen prej 200 mije leke

**Aktiviteti “Miss Globe 2014”** – realizuar ne shumen prej 500 mije leke

**Aktivitete per Festat e Nentorit.** – realizuar ne shumen totale prej 796 mije leke

**Aktivitete me te Persekutuarit Politike-** realizuar ne shumen prej 245 mije leke

**Aktivitete ne sheshe me rastin e festave te Fund vitit-** realizuar ne shumen 200 mije leke

**Aktiviteti “Ndermendje 2013“** – realizuar ne shumen prej 1 394 mije leke

**Aktiviteti “Asnje femije jashte“**- realizuar ne shumen prej 200 mije leke

**Aktiviteti “Festat e Fund Vitit“**- realizuar ne shumen prej 500 mije leke

**Materiale promovuese per Degen Ekonomike te Kultures** shuma 141 mije leke

**Shperblim per kengetarin Ergi Dini** - realizuar ne shumen prej 100 mije leke

### III. TEATRI MIGJENI

000/leke

NR	Emertimi	Plan 2014	Realizimi 2014
1	Paga	16 696	15 661
2	Sigurime	2 655	2 615
3	Mallra e sherbime	2 389	1 529
4	Transferte korrente te brendeshme	2 500	2 500
5	Investime	1 500	459
<b>TOTALI</b>		<b>25 740</b>	<b>22 674</b>

Per Teatrin ‘Migjeni’ shpenzimet per ‘Mallra e Sherbime’ ne total jane realizura ne shumen prej 1 529 mije leke te ndara sipas tabelës me poshte:

NR	Emertimi	Plan 2014	Realizimi 2014
3	Sherbime nga te trete	811	739
4	Shpenzime transporti	300	314
3	Shpenzime per honorare	425	425
4	Mirembajete zakonshme	500	0
5	Siguracione	53	51
6	Shpenzime prite dhe percjellje	300	0
<b>TOTALI</b>		<b>2 389</b>	<b>1 529</b>

Per Teatrin “Migjeni“ shpenzimet e realizimit 2014, sipas tabelës ndahen: shpenzime per te trete ne shumen prej 739 mije leke, shpenzime transporti ne shumen prej 314 mije leke, shpenzime per honorare eshte realizuar ne shumen prej 425 mije leke, e ndare: 225 mije leke honorare per bordin artistik te Teatrit, dhe 200 mije leke per aktivitetin “Me humorin shkodrane ne vite“, si dhe shpenzime per siguracione ndertese ne shumen prej 51 mije leke.

Ne zerin transferime ne shumen prej 2, 500 mije leke jane perfshire shpenzimet per honorare per projektet artistike si me poshte:

- Komedia “Eldorado“ 600 mije leke
- Komedia “Nje dyzine me trendafila “ 250 mije leke
- Komedia“Rendesia e te qenurit i ndershem“ 800 mije leke
- Drama “ Gjaku i Arberit“ 600 mije leke
- Humor “Variete Show“ 250 mije leke

Zeri investime eshte realizuar shuma prej 459 mije leke, per pasqyrimin e fotove ne vite ne ambientet e teatrit.

#### IV. SPORT KLUB VLLAZNIA

000/leke

NR	Emertimi	Plan 2014	Realizimi 2014
1	Paga	7 588	7 257
2	Sigurime	1 212	1 212
3	Mallra dhe sherbime	22 591	21 884
4	Transferte korrente te brendeshme	2 480	2 480
6	Investime	80	64
<b>Shuma</b>		<b>33 951</b>	<b>32 897</b>

000/leke

NR	Emertimi	Plan 2014	Realizimi 2014
4	Materiale dhe sherbime speciale	17 391	17 254
5	Sherbime me te trete	1 045	717
7	Mirembajete e zakonshme	200	200
8	Shpenzime tjera operative	3 955	3 713
<b>Totali</b>		<b>22 591</b>	<b>21 884</b>

**Aktiviteti sportiv** – ku perfshihen zeri materiale dhe sherbime speciale dhe zeri shpenzime tjera operative ne total ne shumen prej **20 967** mije leke, perfshin trajtimet ushqimore te sportistevë, shpenzimet e udhetimit per pjesemarrje ne kampionate te ndryshme kombetare, shpenzimet per udhetim e dieta per sportistet pjesmarres ne kampionate kombetare e nderkombetare, pagese e gjygtareve etj, sipas klasifikimit bere nga Sport KlubVllaznia duke filluar nga ekipet me rezultate me te mira.

**GRUPI A**

- a. **Boksi**, Ne total shuma **2 898** mije leke e ndare: Pagesa traniera me honorare **355** mije leke shpenzime per trajtim ushqimore **2 455** mije leke Materjale sportive **88** mije leke.
- b. **Basketboll, M +F** Ne total shuma **5 553** mije leke e ndare: Pagesa traniera me honorare **690** mije leke, shpenzime per trajtime ushqimore **4 670** mije leke, materjale sportive **73** mije leke Pagesa gjyqtare te basketbollit **120** mije leke.
- c. **Volejball, M + F** Ne total shuma **4 712** mije leke e ndare: Pagesa traniera me honorare **690** mije leke, shpenzime per trajtime ushqimore **3 882** mije leke, materjale sportive **69** mije leke pagesa gjyqtare te voleibollit **71** mije leke.
- d. **Atletike**, Ne total shuma **2 728** mije leke e ndare: Pagesa traniera me honorare **368** mije leke, shpenzime trajtime ushqimore **2 264** mije leke, materjale sportive **96** mije leke.
- e. **Peshngritje**, Ne total shume **2 571** mije leke e ndare: Pagesa traniera me honorare **414** mije leke, Shpenzime trajtime ushqimore **2 090** mije leke, Materiale sportive **67** mije leke
- f. **Gjimmastike**, Ne total shuma **638** mije leke e ndare: Pagesa traniera me honorare **138** mije leke, shpenzime trajtime ushqimore **500** mije leke.

**GRUPI B**

- a. **Mundje e lire**, Ne total shuma **523** mije leke e ndare: Pagesa traniera me honorare **138** mije leke, shpenzime trajtime ushqimore **385** mije leke.
- b. **Ciklizem**, Ne total shuma **483** mije leke e ndare: pagesa traniera me honorare **138** mije leke Shpenzime trajtime ushqimore **345** mije leke.
- c. **Shah**, Ne total shuma **138** mije leke e ndare: Pagesa traniera me honorare **138** mije leke
- d. **Xhudo**, Ne total shuma **368** mije leke e ndare: Pagesa traniera me honoarare **138** mije leke Shpenzime trajtime ushqimore **230** mije leke.
- e. **Hendboll**, Ne total shuma **78** mije leke e ndare: Pagesa traniera me honorare **78** mije leke
- f. **Pingpong**, Ne total shuma **115** mije leke e ndare: Pagesa traniera me honorare **115** mije leke
- g. **Not**, Ne total shuma **112** mije leke e ndare: Pagesa traniera me honoarare **72** mije leke shpenzime per trajtime ushqimore **40** mije leke.

**Aktivitete shitese**

Me rastin e perfundimit te vitit kalendarik, klubi shumesportesh “ **Vilaznia**” organizon aktivitetin festiv “ **Shpallja e sportistev me te mire te vitit**”, shuma shpenzuar **50** mije leke.

**Zeri transferta korente** ne total shuma prej **2 480** mije leke ndahet:

- Aktiviteti Nderkombetar i Boksit “Vllaznia 2014” ne shuma prej 900 mije leke.
- Shtese fondit ekipit boksit si Shoqate shuma 332 mije leke
- Shtese fondi per Akademeine e futbollit 200 mije leke, shperblime per rezultate te mira.
- Shperblim per Kampionin e Europes Erkand Qerimaj 500 mije leke
- Shperblim per ekipin basketbollit Kampion shuma 500 mije leke
- Kompensime ushqimore familjare, ne shumen prej 48 mije leke

**Zeri Investime** eshte realizuar ne shumen prej 64 mije leke blerje paisje kompjuterike

## V. SHERBIMET SOCIALE

000/ leke

Nr	Lloji i sherbimit	Plani 2014	Realizimi 2014
1	Sherbime komunitare “Marlulaj” dhe “Kiras”	724	107
	<i>Transferime Sherbime komunitare “Marlulaj” dhe “Kiras”</i>	600	0
	<i>Energji elektrike</i>	60	44
	<i>Uje</i>	64	63
2.	Mirembajtje-zakonshme-Qendra Zhvillimit	200	131
3	Sherbimi Anti - dhune	130	0
4	Sherbimi i Mbrojtje se Femijeve	130	0
5	Guida e Sherbimeve Sociale	100	0
6	Plani Social i Zones	100	0
7	Sherb. Komunitare Familje/Gra/Femije	384	0
8	Sherbime komunitare per te moshuar	360	0
	<b>Totali</b>	<b>2 128</b>	<b>238</b>

Sherbimi social per vitin 2014 eshte planifikuar te realizohet ne mbeshtetje te Planit Social te Zones, te miratuar nga Keshilli i Bashkise ne vitin 2008. Ne baze te ketij instrumenti, fokusohen sherbimet sipas target-grupeve te parashikuara: femije, gra dhe te moshuar me prioritet sherbime sociale alternative per keto kategori sipas problematikave qe

secili prej tyre paraqet. Nga sherbimet e ofruara ne zyre kane perfituar shume kliente te cilet i jane drejtuar Zyres se Sherbimeve Sociale, ku funksionojne: Komisioni i Vleresimit te Nevojave dhe Komisioni Multidisiplinar per Kujdestarine.

Zyra per Mbrojtjen e Femijeve, si cdo vit tjetër, ka evidentuar rastet e dhunes, shfrytezimit dhe neglizhimit te femijeve dhe ka koordinuar veprimet me aktoret publike dhe private te fushes sociale per lehtesimin apo zgjidhjen e rasteve te evidentuara. Gjate vitit 2014, eshte mbledhur 3 here Komisioni Multidisiplinar per 3 raste emergjente qe kane patur nevojë per koordinim pune mes te gjithë aktoreve te ketij grupi. Zyra per Mbrojtjen e Femijeve, per vitin 2014 ka trajtuar 67 raste.

Zyra per barazine gjinore dhe kunder dhunes ne familje ka ofruar sherbimin per evidentimin dhe masat mbrojtëse ndaj viktimave te dhunes ne familje. Kete vit, ky sherbim me se tepermi eshte ofruar ne takime te drejtperdrejta. Grupi teknik i punes per rastet e dhunes ne familje eshte mbledhur cdo 4 muaj, dhe eshte diskutuar per rastet me eksteme te cilat kane patur nevojë per nderhyrje emergjente ka secili prej anetareve te grupit teknik te dhunes ne familje. Gjate vitit 2014, bashkepunimi ka qene me se shumti me Drejtorine e Policise se Qarkut Shkoder, Gjykaten e Rrethit Gjyqësor dhe organizatat qe veprojnë ne qytetin e Shkodres. Per vitin 2014 jane zbatuar 44 vendime te gjykates (urdhera mbrojtje dhe urdhera te menjehershëm mbrojtje) dhe jane trajtuar 32 raste dhune ne familje.

**Projekti Shpresa**- sipas kontates te lidhur mes Bashkise Shkoder dhe Projektit “Shpresa” me nr 703 date 18. 02 2013 “ **Per percaktimin e fondit dhe proceduren e levrimit te tij per pagat e personelit sherbyes per projektin Shpresa**” neni 2, sipas te cilit Bashkia merr persiper sigurimin e fondit per paga e sigurime te 26 punonjesve qe ofrojne sherbime ne 7 komunitete rezidenciale ( Shtepi – Familje) qe ndodhen ne territorin e Bashkise Shkoder, nga te cilet jane 24 kujdestare qe kryejne sherbim ne 24 ore ne baze te turneve te percaktuara dhe rregullores se brendshme te Shtepi-Familje. Per vitin 2014, plani per projektin “**Shpresa**” ishte **11 538 mije** leke nga te cilat jane shpenzuar **11 530 mije** leke, te ndara:

000 /leke

Periudha	Paga	Sig. shoq	T. A. P	Totali
Janar - Dhjetor	8 611	2 757	162	<b>11 530</b>

Fokus grupet perfituese te sherbimeve ne keto shtepi - familje jane: 60 femije, e te rinj e te reja, te privuar nga referimet familjare, me paaftesi psiko-fizike dhe shqisore, te deinstitutionalizuar nga Qendrat Psikiatrike Shteterore dhe Jetimorete e rretheve te ndryshme te Shqiperise te mirepritur ne Shtepi-Familje ku kane gjetur nje pergjigje globale te nevojave te tyre dhe ne veçanti jane shoqeruar ne udhetimin e tyre drejt autonomise dhe integritimit ne Shoqerine Civile.

## I. ÇERDHE

Viti 2014	Totali	Paga	Sigurime	Mallra e Sherbime	Investime	Transferta per individ
<b>Plani</b>	<b>27 539</b>	<b>17 531</b>	<b>2 804</b>	<b>6216</b>	<b>830</b>	<b>158</b>
<b>Realizimi 2014</b>	<b>25 151</b>	<b>15 942</b>	<b>2 662</b>	<b>5811</b>	<b>598</b>	<b>138</b>

- Ne zerin e pagave fakti perfshin vleren 15. 942 mije leke..
- Ne zerin e sigurimeve fakti eshte 2. 662 mije leke.
- Ne zerin “mallra dhe shpenzime te tjera” realizimi eshte **5 811 mije Leke**:
  - Ne zerin “Materiale dhe sherbime speciale “ fakti eshte **3. 502** mije leke. Kjo vlere perfaqson shpenzimet per ushqime.
  - Ne zerin “Sherbime nga te trete” fakti eshte **1772 mije leke**.
    - Shpenzimet per energjine elektrike qe perfshin shumen prej 557 mije leke
    - shpenzimet per konsumin e ujit me vlere prej 938 mije leke
    - blerje lende djegese ( dru zjarri) 277 mije leke
  - Ne zerin mirembajtje te zakonshme fakti eshte **297** mije leke.
    - mirembajtje te ndertesave jane shpenzuar 264 mije leke,
    - mirembajtja e aparateve teknike jane shpenzuar 33mije leke.
  - Ne zerin Qera objekti vlere prej **240 mije** leke e planifikuar eshte realizuar 100%.
- Ne zerin “Investime” fakti eshte **598 mije leke**. Te kjo vlere perfshihet shuma prej 149 mije leke qe eshte perdorur per Rikonstruksionin e Çerdhes “1 Qershori”(kanalizimin e ujerave te zeza), shuma prej 150 mije leke eshte perdorur per Rikonstruksioin e Çerdhes “M. Alimani”, (vendosjen e dyerve te reja ), ndersa vlere prej 191 mije leke eshte shpenzuar per rikonstruksionin e Çerdhes “Perash”(per sovatinin e murit rrethues te saj). Vlere prej 50 mije leke eshte shpenzuar per blerje paisje (1 lavatrice). Ndersa tek zeri paisje zyre jane shpenzuar 58 mije leke per blerjen e nje fotokopje.

DREJTORIA E PROMOVIM ZHVILLIMIT, STATISTIKAVE DHE Z1N &  
DREJTORIA E KOORDINIMIT PROJEKTEVE DHE MARRDHENIEVE  
NDERKOMBETARE.



Gjate vitit 2014, nga Drejtoria e Promovim Zhvillimit, Statistikave, Zyra me nje Ndalese dhe Drejtoria e Koordinim Projekteve, Marredhenieve me Jashte jane realizuar nje sere aktivitetesh dhe projektesh.

Zyra eshte angazhuar aktivisht ne pregatitjen e dokumentave te rendesishem si edhe ne pregatitjen e materialeve promocionale me qellim promovimin e qytetit te Shkodres dhe me gjere si nje destinacion i rendesishem turistik. Ketu mund te permendim pjesemarrjen ne takime te ndryshme per zhvillimin e sektorit te turizmit te hartuar nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

Eshte mbeshtetur Bordi i Rinise ne lobimin per pjesemarrjen e tyre ne vendimmarrje e iniciuar nga organizata IRSH. Zyra eshte konsultuar nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, ne hartimin e Strategjise se Zhvillimit te Turizmit 2014-2015 si edhe ne pregatitjen e materialeve te ndryshme promovuese per turizmin ne Shkoder.

Gjate vitit 2014, nga Zyra e Programim Zhvillimit, jane zhvilluar nje seri aktivitetesh ne kuader te projekteve te ndryshme ne bashkepunim me partnere te rendesishem kombetar dhe nderkombetar. Zyra ka pasur nje rol aktiv ne konferenca dhe seminare lokale, kombetare dhe rajonale ne te cilat eshte ftuar.

Zyra e Promovim Zhvillimit ka marre pjese ne me shume se 12 aktivitete te ndryshme ne kuader te projekteve qe implementohen ne territorin e Bashkise Shkoder e me gjere. Keto projekte prekin nje seri temash te rendesishme per zhvillimin e qendrushem ekonomik te qytetit si zhvillimi ekonomik me ne fokus zhvillimin e turizmit, mbrojtjen e mjedisit, koezionin social te shtresave ne nevoje, rinine etj.

Nje rol te rendesishem ka luajtur zyra ne perditesimin e faqes web te Bashkise Shkoder duke ofruar kontributin e saj ne hartimin e nje koncepti dhe dizajni te ri per te permiresuar me tej funksionalitetin dhe rritur atraksionin e saj.

I rendesishem ka qene pregatitja e dokumentacionit per pjesemarrjen ne projektin “Cressida”, projekt i financuar nga EPA (Agjensia Amerikane e Mjedisit) i cili konsiston ne permiresimin e menaxhimit te ujerave nderkufitare e ne kete rast per lumenjte **Drin e Drina**.

**Organizimi i dites se Liqenit**

Me date 21 Qershor 2014, ne kuader te Dites se Liqenit Bashkia Shkoder ne bashkepunim me Shoqaten e Sporteve te Ujit, Drejtorine Rajonale te Arsimit, Universitetin Luigj Gurakuqi dhe Klubin Shume Sportesh Vllaznia u zhvilluan nje sere aktivitetesh me karakter promocional, ndergjegjesues si dhe nje sere garash te sporteve ujore me pjesmarrjen e sportistev te ekipeve te meshkujve dhe femrave te Klubit Vllaznia, Universitetit dhe te Shkollave te qytetit. U zhvillua gara e maratones se notit me distance 1.5 km per femra dhe meshkuj nga Zalli i Bardhe – Shiroke. Gjithashtu u zhvilluan garat e notit te shpejtesise Rrasa e Pare – Moloja Shiroke. Nje vemendje te vecante nga vizitoret paten garat e **waterpolit** qe u zhvilluan ndermjet ekipeve te Klubit te Vllaznise, Universitetit dhe Shkollave te Mesme te Qytetit. Gjithashtu ne kuader te promovimit teaktivitetev sportive me mjete lundruese u zhvilluan gara demonstrative me **water ski** dhe **wake board**. Nga dashamires te promovimit te lundrimit me mjetet lundruese te tradites u unaguraa mjeti lundrues barke me rrema me kapacitet me 18 lundrues.

**Zhvillimi i aktiviteve promovuese te Zones se Permiresimit te Biznesit te rruges 13 Dhjetori dhe 28 Nentori.**

Ne kuader te promovimit te biznesit te qytetit dhe ne menyre specifike te bizneseve te Zones se Permiresimit te Biznesit te qendres historike te qytetit, Bashkia Shkoder ne Bashkepunim me BID – rruga 28 Nentori ka zhvilluar nje sere aktivitetesh, permes burimeve te saj financiare dhe mbeshtetjes nga ana e “Fondacionit Shqiptaro – Amerikan te Zhvillimit-(AADF)”. Aktivitetet kane konsistuar ne zhvillimin e panairove te ndryshme me pjesmarrjen e bizneseve te qytetit dhe sidomos atyre te punimeve artizanale. Me qellim berjen e zones sa me terheqese per vizitoret dhe klientet jane mbeshtetur dhe zhvilluar nje sere aktivitetesh kulturore te cilet kane kulmuar sidomos gjate festave te muajit nentor dhe festave te fundevitit.

Vlen te permendet qe per vitin 2014 ishte nje risi ngritja e tregut te perkohshem me produkte te prodhimeve vendase agroushqimor te Shkodres dhe prodhimeve artistike artizanale. Gjate gjithë diteve u zhvilluan nje sere aktivitetesh me lojra per femije te animuara nga aktore te ndryshem. Gjate neteve te fundvitit u zhvilluan koncerte muzikore live nga te rinj te talentuar te qytetit duke krijuar nje atmosfere me te vertete festive deri ne oret e vona te mbremjes.

Permes mbeshtetjes se vazhdueshme te kesaj shoqate nga ana e Fondacionit Shqiptaro–Amerikan te Zhvillimit (AADF), bizneset qe ushtrojne aktivitetin ne zonen “Rr. 13 Dhjetori–Rr. 28 Nentori” kane nje sere avantazhesh si: ofrimin e sherbimit te keshillimit per bizneset falas si edhe mundesine e tyre ne aplikimin dhe perfitimin nga programi i granteve.

Gjtae vitit 2013 – 2014 ishin perfitues te mbeshtetjes financiare – grante, 7 njesi biznesi me vlere totale 832 665 leke.

### Ngritja e Zyres me nje Ndalese dhe Inagurimi i saj

Ne muajin Janar 2014, ne mjediset e Bashkise Shkoder u zhvillua ceremonia e inagurimit te ngritjes se “Qendres se Sherbimeve ndaj Publikut” realizuar me mbeshtjen e Programit te Zhvillimit Lokal dhe Decentralizimit (dldp) financiar nga Qeveria Zvicrane dhe Bashkia Shkoder, dhe u mbeshtet teknikisht nga Fondacioni per Autonomi Vendore dhe Qeverisje (FLAG).

Ky projekt eshte iniciative e pare e kesaj permase te realizuar nga Bashkia dhe nje nder projektet me te rendesishme per institucionin tone.

Bashkia Shkoder ka disponuar asete te teknologjise se informacionit si **hardware** dhe **software** per disa sherbime te caktuara, te cilat nuk kane qene te integruara ne nje sistem te vetem informacioni i cili do t'i sherbente rritjes se efikasitetit te sherbimit dhe informimit ndaj qytetarve dhe biznesit.

Sistemi i ofrimit te sherbimeve ndaj qytetareve dhe biznesit, pas realizimit te ketij projekti, nga ana e Bashkise Shkoder ka patur nje permiresim te dukshem. Megjithate eshte ballafaquar me nje sere problematikash. Si pasoje e fragmentimit dhe mosintegritimit te sistemeve te informacionit disponibel ne Bashkine Shkoder, qytetaret perballen here-here me kohezgjatje te panevojshme ne marrjen e informacionit qe u nevojitet dhe sherbimeve te kerkuara.

Kjo tablo e funksionimit te administrates vendore dhe marredhenieve te saj me komunitetin shtron domosdoshmerine e permiresimit te situates permes adoptimit te nje qasjeje me te avancuar te realizimit te funksioneve publike te orientuara me teper drejt nevojave te qytetareve dhe rritjes se nivelit dhe cilesise te sherbimeve te ofruara.

Ngritja e zyres me nje ndalese ku qytetaret kane mundesi te marrin nga nje zyre e vetme dhe e posaqme kontakti brenda nje kohe sa me te shkurter te mundshme te gjithe informacionin, dokumentacionin e nevojshem per realizimin e nevojave te qytetareve ndikon ne permiresimin e informimit dhe komunikimit te Bashkise Shkoder me qytetaret e saj dhe biznesin duke rritur transparencen dhe efektivitetin e administrimit dhe funksionimit te Bashkise.

Ne kuader te ketij projekti ne kemi realizuar:

Ndertimin e Zyres me nje ndalese ne Bashkine Shkoder si qender sherbimesh ndaj qytetareve dhe biznesit me infrastrukturen fizike dhe te logjistikes se nevojshme per funksionimin e ZIN, si dhe Sistemin IT funksional dhe i pajisur me infrastrukturen e nevojshme **Hardware** dhe **Software**.

Gjithashtu eshte realizuar Ngritja i nje sporteli te vetem te sherbimeve sociale me fokus gjinor dhe shtresat e margjinalizuara.

Edhe nga ana e pozicionimit dhe konceptimit arkitektonik te zyres, ajo luan nje ure lidhese ndermjet nderteses se administrates se bashkise dhe asaj te Keshillit te Bashkise, me prezencen e qytetareve ne gadishmeri per t'ju pergjigjur dhe komunikuar me ta.

Une me kete rast do t'i adresoj nje falenderim te madh ne rradhe te pare Programit DLDP me perfaqesuesit e tyre ne Shkoder per mbeshtetjen ne realizimin e ketij projekti kaq te rendesishem, asistencen profesionale teknike te ofruar nga organizata FLAG-ut dhe stafin e Bashkise Shkoder qe mundesuan realizimin e ketij projekti.

### **Projekti Matra CoPROI - “Udheheqja per Sigurine dhe Sundimin e Ligjit”**

Bashkia Shkoder, eshte pjese e programit Matra CoPROI, ne kuader te se cilit po zbatohet projekti, i financuar nga nga Ministria e Puneve te Jashtme Hollandese, i cili ka per qellim forcimin e aftesive te lidershipit demokratik te institucioneve qeverisese ne Shqiperi dhe ne rajon, si dhe per te siguruar te drejtat e njeriut, sigurine publike dhe integrimin e metejshem te reformave ne kuader te standarteve europiane.

Qellimi paresor i ketij projekti eshte identifikimi i sfidave dhe ceshtjeve kyçe ne fushen e sigurise Bazuar ne informacionin e mbledhur gjate uorkshopeve, nje draft pyetesor eshte perpiluar duke adresuar pyetje mbi perceptimin e sigurise publike per qytetaret dhe per sondazhin ne nivel qendror per institucionet publike qe ofrojne te dhena zyrtare ne kete fushe.

### **Zbatimi i projekteve ne vazhdim ne kuader te programit IPA per vitin 2014**

#### **Projekti Legend**

##### **Aktivitetet e realizuara per 2014**

- ✓ 10 raste demonstrimi qe shfrytezojne teknologjite GCHP ne ndertesat publike te Italise, Kroacise, Shqiperise, Malit te Zi dhe Bosnje - Hercegovines ;
- ✓ Analiza SWOT me anketa para investimi dhe metodat e Analizes se Ciklit te Jetes per te mbeshtetur administraten publike ne zgjedhjen e teknologjise se pompave te ngrohjes me efektive dhe me miqesore ndaj mjedisit;
- ✓ Workshope me tematike rritjen e njohurive mes aktoreve kryesore publike dhe private mbi praktikat me te mira te teknologjive GCHP ne nivel europian, per ndertesa rezidenciale, publike dhe industriale ;
- ✓ Seminare teknike per te rritur teknikat know-how ne teknologjite GCHP dhe aftesite e te gjitha aktoreve perkates (menaxhere te energjise dhe specialiste nga sektoret publik dhe privat);

#### **Projekti Marubi**

##### **Aktivitetet e realizuara per vitin 2014**

Ne kuader te projektit “MARUBI, nje model bashkepunimi per promovimin e turizmit mes Shkodres dhe Ulqinit” financuar nga probami IPA CBC Shqiperi – Mali i Zi i cili udhehiqet nga Bashkia e Shkodres u organizuan:

- ✓ Realizimi i ekspozites itinerante “Reflektojme Traditat tona, Reflektojme Vetveten”. Objekti i ekspozites ishte pasqyrimi i traditave kostumografike shqiptare dhe malazeze permes perzgjedhjes se 30 fotografive nga fondi Marubi (15 fotografi te kostumeve shqiptare dhe 15 malazeze). Ne te njejten kohe ekspozita promovon vlerat historike, sociale dhe kulturore te Shkodres dhe zonave perreth duke e bere ate

atraktive per turistat e huaj por dhe duke prezantuar qytetin ne sy te Europes ne Parlamenti European, ne Bruksel me date 20 - 22 Janar 2014. Eventu organizohej nen kujdesin e vecante te Eurodeputetit Nikolas Vujanic (reporter per shqiperine ne PE) dhe Sh. S. Mimoza Halimi (Ambasadore e Misionit te Shqiperise prane BE). Te pranishem ne event ishin figura te shquara te politikës artit dhe kultures ne institucionet e Bashkimit European si Znj. Doris Pack, Z. Eduard Kukan, Znj. Dubravka Šuica deputet ne PE, gjithashtu Drejtori per Ballkanin ne Drejtorine e Pergjithshme te Zgjerimit ne Komisionin European Z. Jean-Eric Paquet e shume personalitete te shquara te diplomacies shqiptare dhe malazeze ne BE.

- ✓ Realizimi i ekspozites itinerante “Reflektojme Traditat tona, Reflektojme Vetveten” ne Trieste te Italise me date 23 - 25 Janar 2014, ekspozita u zhvillua nen kujdesin e vecante te Presidentit te Keshillit Rajonal z. Franco Iacop
- ✓ Me rastin e vizites ne Shkoder te Ambasadorit te Delegacionit te Bashkimit Evropian ne Shqiperi, Z. Ettore Sequi, ditën e premte, date 14. 02. 2014 u hap serish ekspozita Itinerante Marubi "Reflecting our traditions, reflecting ourselves" ne ambjentet e Bashkise Shkoder!
- ✓ Realizimi i ekspozites itinerante ne Shqiperi. Ne mars 2014 ekspozita Marubi hapet ne qendren e informimit te BE ne Tirane. Ne prill 2014 ekspozita Marubi u hap ne qendren e informimit te BE ne Vlore ku qendroi e hapur mbi 10 dite.
- ✓ Realizimi i ekspozites itinerante “Reflektojme Traditat tona, Reflektojme Vetveten” ne muajin Maj 2014, ne kryeqytetin e Hungarise Budapest, ne sallën kryesore te Muzeut Kombetare te Hungarise. Te pranishem ne event ishin figura te shquara te Parlamentit, Politikës, Diplomacisë. artit dhe kultures vendit mikeprites.
- ✓ Realizimi i ekspozites itinerante “Reflektojme Traditat tona, Reflektojme Vetveten” ne muajin Maj 2014, ne kryeqytetin Serbise Beograd, ne ambjentet e Muzeut Etnografik. Ne hapje te ftuarit i priti Miroslav Tasic, drejtori i Muzeut Etnografik ne Beograd, i cili tha se me kenaqesi hapte ekspoziten “.Mendoj se Muzeu Etnografik ne Beograd eshte vendi i duhur per takimin e dy kulturave, dy popujve dhe dy shteteve.
- ✓ Realizimi i Marubi Route ne muajin Korrik 2014, ku qyteti i Shkodres zbkurohet me foto, dhe promovohet si djepi i fotografise.
- ✓ Realizimi ne muajin Korrik – Gusht 2014 i Festivalit Marubi “Djepi i fotografise dje, sot dhe neser” ne muajin Korrik – Gusht 2014, nje festival ky qe promovon vlerat historike, sociale dhe kulturore te Shkodres dhe zonave perreth duke e bere ate atraktive per turistat e huaj dhe krahinave mbare Shqiptare.
- ✓ Realizimi i seminarit, konkursit te fotografise dhe çmimit Marubi. Ku iu dha rast fotografeve te rinj dhe me eksperience te fotografoje qytetin e Shkodres brenda nje dite.
- ✓ Ne 30 Korrik u oragnizua Konferenca finale e projektit “Maubi nje model bashkpunimi per promovimin e turizmit ndermjet qytetit te Shkodres dhe Ulqinit “.

### **Projekti EURO MIGMOB**

#### **Aktivitetet e realizuara per vitin 2014**

Projekti EuroMigMob eshte nje projekt i financuar nga BE ne kuader te programit **Europe for Citizens**. Ky projekt udhëhiqet nga Bashkia e Shkodres dhe ka ne qender te vemendjes levizjet migratore ne europe. Partnere te projektit jane 23 bashki dhe komuna nga Italia, Franca, Rumania dhe Hungaria. Ne kuader te ketij projekti organizohen 4 takime 3 ditore (Shkoder, Masafra, Sardegnia dhe Bruksel) ku te gjithë partneret shkembejne eksperiencat e tyre ne lidhje me migracionin dhe ndertojne nje rrjet qytetesh te binjakezuara qe do vazhdojne bashkepunimin edhe pas mbarimit te projektit.

- ✓ Ne muajin Shkurt 2014, ne qytetin e Shkodres u zhvillua nje takim 3 ditor me gjithë partneret pjesemarres te cilet kishin rastin te shkembejne pervojat e tyre ne lidhje me migracionin dhe njekohesisht te ndertojne nje rrjet qytetesh te binjakezuara, qe me pas do te kene rastin te vazhdojne bashkepunimin e mirefillte mes tyre”. Gjate diteve te qendrimit ne Shkoder, perfaqesuesit e 23 bashkive e komunave nga Italia, Franca, Rumania dhe Hungaria, zhvilluan takime si dhe vizita ne pikat turistike te qytetit, muzeun historik, fototeken Marubi etj, duke u njohur me nga afer me historine dhe kulturen e qytetit te Shkodres.
- ✓ Ne muajin Maj 2014, ne qytetin e Massafres ne Itali u zhvillua nje takim 3 ditor me gjithë partneret pjesemarres te cilet kishin rastin te shkembejne pervojat e tyre ne lidhje me migracionin dhe njekohesisht te ndertojne nje rrjet qytetesh te binjakezuara, qe me pas do te kene rastin te vazhdojne bashkepunimin e mirefillte mes tyre”. U organizua nje aktivitet per promovimin e resurseve te qytetit te Shkodres dhe mundesit e bashkpunimit me shoqaten e bizneseve te qytetit te Massafres.

### **Projekti Adria Muse**

#### **Aktivitetet e realizuara per vitin 2014**

Ne bashkpunim me provincen Veneto ne kuader te projektit Adria Muse u organizua **“Ekspozita e mjeteve te lundrimit tradicionale te Venetos dhe qytetit Shkodres”**.

Moren pjese perfaqesues nga Provinca e Venetos artizane te mjeshterise se lundrimit dhe prodhimit te mjeteve lundruese, u demonstruan teknikat e ndertimit te mjeteve lundruese nga mjeshttrat Italian dhe artizane te Shkodres.

### **Zbatimi i projekteve ne bashkepunim me RDP per Shqiperine e Veriut**

#### **Ndertimi i Sistemit te ndricimit te Rruges Ura e Bunes-Shiroke.**

Ne kuader te Programit Zhvillimi Rajonal i Shqiperise se Veriut (RDP), Bashkia Shkoder ka zbatuar projektin “Ndertimi i sistemit te ndricimit i rruges “Ura e Bunes – Shiroke” me vlefte prej 109, 493. 23 Euro te financuar nga RDP. Gjate vitit 2014 eshte realizuar 90 % kryerja e punimeve per te cilat jane parashikuar. Jane instaluar shtyllat dhe ndricuesat pergjate rruges Ura e Bunes – Shiroke, mbetet per tu kryer dhe lidhja me energjine elektrike.

### **Zhvillimi i turizmit mjedisor ne lumin Buna dhe Liqenin Shkoder.**

Ne kuader te Programit Zhvillimi Rajonal i Shqiperise se Veriut (RDP), Bashkia Shkoder ka zbatuar projektin me vlere totale 124, 567 Euro. Bashkefinancimi i ketij projekti nga ana e bashkise eshte 24, 913 Euro.

Aktivitetet qe jane zbatuar gjate vitit 2014 jane:

✓ **Promovimi i Liqenit te Shkodres dhe lumit Buna si nje destinacion turistik.**

Ne kuader te ketij aktiviteti eshte realizuar pasurimi me informacion i faqes se internetit te bashkise per liqenin e Shkodres dhe lumit Buna.

- Prodhimi i fletpalosjeve me nje permbledhje te specieve te liqenit te Shkodres dhe ndertimin e 1 tabelave informuese prane liqenit.
- Grupe te rinjsh vullnetare kane realizuar here pas here pastrimin e bregut te liqenit nga mbetjet urbane, duke dhene edhe mesazhin qe te gjitha te behemi kontributor per nje mjedis te pastër.
- Aktiviteti i rradhes ne kuadrin e projektit per promovimin turistik te zones se Liqenit te Shkodres. Femijet e shkollave te qytetit konkuruan ne piktore me teme Mbrojtjen e Ambientit ne zonen e Liqenit ku 3 çmime fituese jane ndare nga juria profesioniste e cila vleresoj maksimalisht perpjektet e femijeve ne kete fushe.
- Aksion per pastrimin e bregut te liqenit i femijeve te shkolles se Shirokes, etj

✓ **Pastrimi i brigjeve te lumit Buna nga Qendra Oblike deri tek ura e Bunes dhe pergjate bregut perendimor te liqenit te Shkodres.**

Ne kuader te ketij aktiviteti jane pastruar nga mbetjet e ndryshme rreth 62 800 m2 siperfaqe e bregut te lumit buna dhe bregut perendimor te liqenit. Gjithashtu jane blere dhe priten instalohen pergjate bregut te liqenit dhe lumit Buna, ne momentin perfundimit te rruges Shirokes sipas nje plani te detajuar, rreth 26 kontinier 1100 litersh dhe 36 kosha mbeturinash 20 litersh.

✓ **Rehabilitimi i plazheve te liqenit dhe ndertimi i infrastruktures per aktivitete rekreative.**

Ne kuader te ketij aktiviteti tenderuar dhe shpallur firma fituse dhe ka filluar zbatimin e ketij aktiviteti. Gjate vitit eshte zbatuar 70 % e punimeve te parashikuara si rehabilitimi i plazheve te liqenit me infrastrukturen e parashikuar sipas projektit.

## DREJTORIA E KOORDINIMIT TE PROJEKTEVE

Tabela 1. Permbledhese

000/ leke

Nr	Emertimi	Plani 2014	Fakti 2014
I	Paga	2 677	2 506
II	Sigurime Shoqerore	426	419
III	Shpenzime Operative	480	475
IV	Investime	3 499	0
<b>Totali</b>		<b>7 082</b>	<b>3 400</b>

- **Ne zerin e pagave dhe sigurime shoqerore** eshte planifikuar **3 103 mije leke** per vitin 2014 dhe jane shpenzuar **2 925 mije leke**.

- Ne zerin 602 « *Shpenzime operative* » eshte planifikuar shuma **480 mije leke** per “*Pritje percjellje*” per vitin 2014 dhe jane shpenzuar **475 mije leke**.
- Ne zerin 231 « *Investime* » eshte planifikuar shuma **3499 mije leke** per bashkfinancimin ne projektin **Zhvillimi i turizmit mjedisor ne lumin Buna dhe Liqenin Shkoder** me Programin e Zhvillimit Rajonal te Shqiperise se Veriut (RDP), per vitin 2014 dhe jane shpenzuar **0 mije leke**, ky investim do te behet ne vitin 2015.



## DREJTORIA JURIDIKE DHE ASETEVE

Mbeshtetur ne buxhetin e vitit 2014 si dhe vendimeve te Keshillit te Bashkise Shkoder, nga Drejtoria Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve kane kryer sherbimet si vijon:

### Spektori Juridik:

#### Gjate vitit 2014 sektori juridik ka zhvilluar veprimtarine e tij ne:

- ✓ Dhenien e ndihmes juridike per veprimtarine dhe aktet e Keshillit Bashkiak, komisionet e tij, Kryetarit te Bashkise dhe aparatit administrativ.
- ✓ Ka perfaqesuar institucionin apo strukturat e Bashkise ne proceset gjyqesore, ku ato jane apo behen pale, me autorizim te Kryetarit te Bashkise apo te Keshillit Bashkiak.
- ✓ Ne bashkepunim me administraten e Bashkise dhe te gjitha institucionet e varesise se saj, ka ofruar ndihmen dhe asistencen juridike per hartimin e marreveshjeve me organizatat dhe institucione te tjera. Ka hartuar kontrata me objekte te ndryshme si ato te sipermarrjeve, supervizimit, kolaudimit etj.
- ✓ Marrjen pjese aktive ne komisionet e shpronесimit, te qirave, te vleresimit dhe privatizimit te banesave shteterore te mbetura pa likujduar.
- ✓ Ka trajtuar dhe zgjidhur, brenda kuadrit te kompetencave, kerkesat dhe ankesat e qytetareve qe i drejtohen Departamentit Ligjor.
- ✓ Ka realizuar vertetime rajoni per sakesim adrese sipas kerkesave te qytetareve.

Gjate vitit 2014 ka perfaqesuar ne 107 procese gjyqesore me objekte gjykimi te ndryshem prej te cilave 13 ka perfunduar gjykimi, 25 ka pushuar gjykimi, 69 vazhdon gjykimi. Ne zbatim te VKM 608 dt. 05. 09. 2012”Per percaktimin e procedures se kalimit te pronsise te pasurise se paluajtshme, te ndertuar deri me dt. 10. 08. 1991 e truallit funksional ne sherbim te tij, po shqyrton dokumentacionin per rreth 19 kerkesa te paraqitura.

### Spektori Prokurimeve Publike:

Konform dispozitave ligjore te parashikuara ne ligjin “Per prokurimin publik” ka hartuar programuar dhe realizuar te gjithе procesin e prokurimeve publike ne menyre elektronike me akses te plote, mbeshtetur ne miratimin e buxhetit per vitin 2014 dhe VKB perkatese, ne vleften **226. 176. 340 leke** nga te cilat:

a- Pune civile	146. 024. 474 leke
b- Furnizime	34. 225. 086 leke
c- Sherbime	31. 986. 646 leke
d- Blerje te vogla	13. 940. 134 leke

**TOTALI = 226. 176. 340 leke**

### Spektori i Aseteve ka ushtrua aktivitetin per:

1. **Procesin e tansferimit te pronave ne njesine e qeverisjes vendore**, mbeshtetur ne dispozitat ligjore:

Me VKM nr. 421, date 2. 06. 2010 “ Per miratimin e listes perfundimtare (te pjesshme)te pronave te paluajtshme publike, shteterore, qe transferohen ne pronesi ose ne perdorim te Bashkise Shkoder, te Qarkut te Shkodres“ pronat qe kalohen ne pronesi te Bashkise Shkoder jane si me poshte:

Ne pronesi te Bashkise Shkoder jane transferuar 241 prona. Jane derguar per regjistrim ne ZVRPP Shkoder 158 prona. Nga keto jane rregjistruar 49 prona dhe mbetet pa rregjistruar nga pronat e derguara 109 prona.

Jane zbatuar te gjitha Vendimet e Keshillit te Ministrave per pronat.

**2. Procesin e kerkesave per shpronesime te cilat kane dale nga Rikonstruksioni i rrugeve te qytetit te Shkodres, mbeshtetur ne dispozitat ligjore:**

- ✓ Eshte pergatitur dokumentacioni per shpronesimin, per interes publik, te pronareve te pasurive te paluajtshme, prone private, qe preken nga zgjerimi i varrezave publike, faza e I dhe II-te, finalizuar me VKM perkatese dhe likujduar plotesisht per sejcilin pronare.
- ✓ Eshte pergatitur dokumentacioni per shpronesimin, per interes publik, te pronareve te pasurive te paluajtshme, prone private, qe preken nga rikonstruksioni i Rruges “Ajasem”, ne Bashkine e Shkodres, finalizuar me VKM perkatese dhe likujduar plotesisht per sejcilin pronare.
- ✓ Eshte pergatitur dokumentacioni per Shpronesimin per interes Publik te pronareve te pasurive te paluajtshme, prone private, qe preken nga rikonstruksioni i rrugeve “Ali Spahija”, “ Nexhip Luli “, “Bujar Bishanaku”, “Stacioni i trenit”, “Rruga e Kalase”, si dhe “Sistemi i Bllokut te pallateve “Qafe Hardhi”.

Dokumentacioni eshte derguar ne Ministrine e Puneve te Brendshme duke u finalizuar me VKM Nr. 623, date 24. 9. 2014, dhe derguar ne ZVRPP Shkoder, duke kryer edhe detyrimet financiare per kryerjen e regjistrimit te ri.

- ✓ Eshte pregatitur dokumentacioni per shpronesim per interes publik te pronareve te pasurive te paluajtshme, prone private qe preken nga Rikonstruksioni i rruges Shkoder – Shiroke dhe Sheshi i Shirokes”, miratuar me VKB.

**3. Procesin kerkesave te qytetareve per pagesen e qerases se truallit nen objekt, mbeshtetur ne dispozitat ligjore.**

**4. Procesin e menaxhimit te pyjeve dhe kullotave komunale te transferuara ne pronesi te Bashkise Shkoder mbeshtetur ne dispozitat ligjore.**

Gjate vitit 2014 eshte punuar ne zbatim te Planit te Menaxhimit te Pyjeve dhe Kullotave komunale per nje afat 10 vjecar te miratuar.

Ne kete plan menaxhimi per pyjet dhe kullotat komunale te bashkise jane parashikuar investime per te cilat ideja dhe qellimi i tyre ka qene rritja e kapaciteteve pyjore dhe atyre prodhuese ne vecanti.

Nga sektori i aseteve jane pregatitur projektet “Ndertim lere uji ne kullota” dhe projekt pyllezimi objekti “Tarabosh” per ngastrat e demtuara nga zjarri.


**DREJTORIA ORGANIZIMIT, PERSONELIT, SHERBIMEVE  
MBESHTETESE, PROTOKOLL ARKIVIT DHE INFORMATIZIMIT**

Drejtoria e Organizimit Personelit dhe Sherbimeve te Brendshme mbulon nevojat per shpenzimet operative per administraten e Bashkise dhe institucionet e varesise ku perfshihen: Teatri, Dega Ekonomike e Kultures, Sportklub "Vllaznia", Zyra e Arsimit (shkollat 9 vjeçare, te mesme, konviktet e sistemit parauniversitar, kopshtet) si dhe Drejtoria e Çerdheve.

000/leke

Nr	EMERTIMI	Plani 2014	Realizimi 2014
I	Paga	97 534	79 674
II	Sigurime Shoqerore	15 686	13 420
III	Shpenzime Operative	44 826	39 940
IV	Investime	2 822	2 741
<b>Totali</b>		<b>160 868</b>	<b>135 775</b>

Per vitin 2014 per zerin « *Paga* » eshte realizuar ne shumen prej **79 674 mije leke**, per zerin « *Sig. shoqerore* » ne shumen **13 420 mije leke**, zeri « *Shpenzime operative* » ne shumen **39 940 mije leke** dhe zeri « *Investime* » ne shumen prej **2 741 mije leke**.

**Shpenzime operative**

000/leke

Nr	Emertimi i shpenzimeve	Plani 2014	Realizimi 2014
6020	Materiale e sherb. zyre te pergjith.	4 210	4 177
6021	Materiale dhe sherbime speciale	646	623
6022	Sherbime	10 951	9 749
6023	Shpenzime transporti	4 230	4 016
6024	Shpenzime udhetimi	700	28
6025	Mirmbajtje e zakonshme	1 822	1 051
6026	Qera objekteve	40	40
6027	Detyrime dhe kompensime legale	10 593	10 593
6029	Shpenzime te tjera operative	11 634	9 663
<b>Totali</b>		<b>44 826</b>	<b>39 940</b>

**Me poshte eshte analiza e shpenzimeve sipas grupeve dhe ne menyre analitike:**

“*Materiale e sherbime zyre te pergjithshme*” realizimi per v. 2014 eshte ne vleren **4 177 mije leke** i detajuar si me poshte:

- ✓ Zeri "**Kancelari**" eshte realizuar me tender ne vleren prej *1 874 mije leke*. Keto shpenzime jane realizuar per te mbuluar kerkesat e drejtorive te administrates se Bashkise, Teatrit, Deges Ekonomike te Kultures, Klubit shumesportesh dhe shkollave te mesme 9 vjecare, arsimit parashkollor, konvikteve te shkollave te mesme te detajuara keto nga Zyra e Arsimit.
- ✓ Zeri "**Materiale per pastrim, dizinfektim**", i parashikuar per blerje materiale pastrimi, shpenzime te cilat ishin planifikuar sipas kerkesave te institucioneve te varesise eshte realizuar me tender ne vleren *2 124 mije leke*.
- ✓ Zeri "**Blerje dokumentacioni**" eshte realizuar ne vleren prej *129 mije leke* per blerje shtypshkrime per nevoja te institucioneve te varesise dhe administrates se bashkise.
- ✓ Zeri "**Furnizime dhe materiale te tjera zyre dhe te pergjithshme**" eshte shpenzuar per pulla takse per vendime gjyqesore ne vleren prej *50 mije leke*.

Zeri "**Sherbime speciale**" eshte realizuar ne vleren prej *623 mije leke* i detajuar si me poshte:

- ✓ Tek zeri "**Uniforma**" i parashikuar per blerje te uniformave te policise bashkiake, bazuar ne vendimin e keshillit te ministrave nr. 333 date 02. 06. 1998 per "Miratimin e normes se veshmbathjes per policine" per kostume, pantallona verore, xhakovento, kemisha, kepuce, pulovra, stema doreza pune etj eshte realizuar ne shumen prej *446 mije leke*.
- ✓ Zeri "**Materiale te tjera**" i parashikuar per blerje materiale te ndryshme elektrike eshte realizuar ne shumen prej *177 mije leke*.

Zeri "**Sherbime**" eshte realizuar ne vleren *9 749 mije leke* i detajuar si me poshte:

- ✓ Zeri "**Energji elektrike**" realizimi per v. 2014 eshte ne vleren prej *3 028 mije leke*.
- ✓ Zeri "**Uje**" i parashikuar per shpenzime uji, realizimi eshte ne vleren prej *466 mije leke*.
- ✓ Zeri "**Telefon**" i parashikuar per shpenzimet per telefonine celulare per titullaret ne baze te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 864, dt 23. 07. 2010 si dhe telefonine fikse per titullaret dhe drejtorite realizimi per v. 2014 eshte ne vleren prej *517 mije leke*.
- ✓ Zeri "**Postare**" i parashikuar per shpenzime sherbime telegrafike e postare, realizimi eshte ne vleren prej *179 mije leke*.
- ✓ Zeri "**Lende djegese**" i parashikuar per shpenzimet per gaz per ngrohje dhe gatim sipas kerkesave te paraqitura nga drejtorite dhe institucionet e varesise eshte realizuar ne vleren prej *3 199 mije leke*.
- ✓ Zeri "**Sherbime te printimit dhe publikimit**" realizimi per v. 2014 eshte ne vleren prej *393 mije leke* per njoftimet ne media.
- ✓ Zeri "**Sherbime te tjera**" i parashikuar per shpenzimet per sherbim interneti, sherbim faqen e internetit te Bashkise, pagese sherbim AKEP etj realizimi eshte ne vleren prej *1 967 mije leke*.

Zeri "**Shpenzime transporti**" realizimi eshte ne vleren prej *4 016 mije leke* i detajuar si me poshte:

- ✓ Zeri “*Shpenzime karburant*” i parashikuar per shpenzimet per blerje karburant per kaldaja dhe automjete, keto sipas nevojave te institucioneve te varesise dhe administrates eshte realizuar ne vleren prej **3 700 mije leke**.
- ✓ Zeri “*Siguracion*” i parashikuar per siguracionet e makinave te administrates, policise bashkiake inspektoriatit ndertimor dhe drejtorise se te ardhurave eshte realizuar ne vleren prej **316 mije leke**.

Zeri “*Shpenzime udhetimi*” realizimi per v. 2014 eshte ne vleren prej **28 mije leke**.

Zeri “*Mirembajtje e zakonshme*” realizimi eshte ne vleren prej **1 051 mije leke** i detajuar si me poshte:

- ✓ Zeri “*Shpenzime per mirembajtjen e objekteve ndertimore*” eshte realizuar ne vleren prej **336 mije leke**.
- ✓ Zeri “*Mirembajtje per aparate paisje teknike*” i parashikuar per mirembajtje aparate teknike, mirembajtje paisje fonie, riparime skanera/pc/fotokopje, printera etj realizimi eshte ne vleren prej **380 mije leke**.
- ✓ Zeri “*Shpenzime te tjera*” i parashikuar per riparimet e avarive te makinave te administrates, policise bashkiake, inspektoriatit ndertimor, drejtorise se te ardhurave, motor gjeneratorit, autoshkalles, elektrovinçit, makines se vizimit, prereses etj eshte realizuar ne vleren prej **335 mije leke**.

Zeri “*Qera objekte*” realizimi per v. 2014 eshte ne vleren prej **40 mije leke**.

Zeri “*Detyrime dhe kompensime legale*” i parashikuar nga Drejtoria Juridike per v. 2014, per ekzekutim vendime gjyqesore eshte ne vleren prej **10 593 mije leke**, procedura qe jane ne proces.

Zeri “*Shpenzime te tjera operative*” eshte realizuar ne vleren prej **9 663 mije leke** i detajuar si me poshte:

- ✓ Zeri “*Aktivitetete te ndryshme*” eshte realizuar ne vleren prej **200 mije leke** per dreken e Iftarit shtruar per besimtarete myslimane nga bashkia.
- ✓ Zeri “*Kosto legale*” ku perfshihen shpenzimet per tarifa kerkese padie eshte realizuar ne vleren prej **17 mije leke**.
- ✓ Zeri “*Siguracion ndertese*” eshte realizuar ne vleren prej **510 mije leke**.
- ✓ Zeri i shpenzimeve per “*Honorare dhe shpenzime kompensimi*” eshte realizuar ne vleren prej **8 234 mije leke** i ndare per: honorare per kujdestaret e njesive administrative ne vleren prej **1 214 mije leke** dhe shpenzime kompensimi per zyrtaret e zgjedhur (K. Bashkiak ) ne vleren prej **7 020 mije leke**.
- ✓ Zeri “*Te tjera materiale e sherbime operative*” realizimi i v. 2014 eshte **702 mije leke**, te cilat jane realizuar per te mbuluar shpenzimet per blerje dhurata, fishekzjarre, flamuj etj.

Zeri “*Investime*” per vitin 2014 eshte realizuar ne vleren **2 741 mije leke** te ndara: Blerje ndertesa dhe konstruksione realizimi eshte ne vleren prej **938 mije leke**, blerje paisje operacionale **100 mije leke**, ndersa per blerje pajisje zyre realizimi eshte ne vleren prej **1703 mije leke**.


**BURIMET E FINANCIMIT****TE ARDHURAT**

Te ardhurat e njesive te qeverisjes vendore perbehen nga:

**I. TE ARDHURAT****II. TE ARDHURAT NGA BURIME KOMBETARE**

000/leke

Burimet e Financimit	Plani 2015
Transferta e pakushtezuar	431 578
Ardhurat e veta	370 140
<b>Shuma</b>	<b>801 718</b>





## TE ARDHURAT

Biznesi konsiderohet si ndervartesi kryesor i mireqenies dhe zhvillimit ekonomik social, me kontribut ne rritjen ekonomike dhe punesimin, prandaj nxitja dhe stimulimi i biznesit eshte nje nga strategjite e qeverise vendore qe realizohet nepermjet politikave te ndryshme fiskale.

Rendesi i jepet permirosimit te metejshem te indikatoreve baze si shkurtimi i metejshem i procedurave per fillimin dhe ushtrimin e aktivitetit, rritja e frymes se konkurrences se ndershme, lufta ndaj sektorit informal, permirosimeve e procedurave tatimore si dhe trajtimi dhe shtrirja ne sherbime on-line dhe te kompjuterizuar.

Bashkia Shkoder ne vecanti i kushton vemendje ruajtjes se klimes se mire te biznesit, fale ndjekjes se strategjive per rritjen e konkurrences se ndershme, uljen e evazionit fiskal, ruajtjen e tendences se rritjes se numrit te bizneseve, krijimin e lehtesirave per bizneset prodhuese dhe me rendesi te vecante strategjike, perhapjen gjeografike te tyre, ruajtjen e larmise se tyre, lehtesimin e procedurave dhe tarifave, si dhe rritjes se transparences dhe frymes se bashkepunimit me tatimpaguesit.

Informacioni mbi kuadrin fiskal si dhe mbi legjislacionin tatimor ne fuqi jepet per te gjitha tatimpaguesit prane sporteleve te sherbimit te Zyres me nje Ndalese, si dhe perditesohet ne menyre dinamike ne faqen zyrtare elektronike te Bashkise Shkoder.

Planifikimi i viti 2015 eshte bere duke ruajtur nivelin dhe strukturen e taksave dhe tarifave te bizneseve dhe familjeve, me nendarje kryesore taksat dhe tatimet, tarifave Vendore, dhe te ardhura jo tatimore.

### Te ardhurat kryesore:

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel, qe mblidhet nga Administrata Tatimore Rajonale Shkoder ne rolin e agjentit nga cdo subjekt qe realizon nje xhiro vjetore me te vogel se 8. 000. 000 leke. Procedurat percaktohen ne ligjin nr. 9632, date 30. 10. 2006, "Per sistemin e taksave vendore", te ndryshuar, ku administrata tatimore pasi mban nje komision prej 1 per qind per sherbimin, transferon te ardhurat ne llogari te bashkise brenda dates 10 te muajit pasardhes.

Taksa mbi pasurine e paluajtshme mblidhet nga administrata e bashkise Shkoder dhe i nenshtrohen te gjitha personat fizike ose juridike, biznese dhe familjare, pronare te pasurive ndertesa. Taksa llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nivelet treguese te takses orientohen sipas aneksit 1 te Ligji 9632 "Per sistemin e taksave vendore" i ndryshuar.

Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja, ku baza e takses eshte vlere ne Leke e investimit te ri qe kerkohet te kryhet, ndersa niveli shprehet si perqindje e vleres se investimit dhe shlyhet nga investitori. E ardhura nga kjo takse mblidhet nga organi qe leshon lejen e ndertimit.

Detyrimi per taksen vjetore te mjeteve te perdorura te transportit rrugor llogaritet sipas pikes 3, te nenit 4 te Ligjit Nr. 9975, dt. 28. 07. 2008 "Per Taksat Kombetare" i ndryshuar. Detyrimi per taksen i takon pronarit te mjetit sipas vendbanimit ose selise se tij. E ardhura nga taksa mblidhet nga strukturat e Drejtorise Rajonale te Sherbimeve te Transportit Rrugor.

Taksa mbi kalimin e te drejtes se pronesise per pasurite e paluajtshme vendoset ne çastin e kalimit te se drejtes se pronesise bazuar ne siperfaqen e ndertimit te prones qe transferohet nga personi qe kalon te drejten e pronesise, dhe llogaritet nga zyrat e regjistrimit te pasurive te paluajtshme ne rolin e agentit tatimor.

Baze e takses se fjetjes ne hotel eshte çmimi i fjetjes, sipas rastit, per dhome ose per person, per nje nate. Niveli i takses eshte 5% e çmimit te fjetjes. Detyrimi per taksen i takon klientit qe strehohet ne hotel dhe mbahet nga hoteli per llogari te bashkise.

Taksa per zenien e hapësires publike per qellime biznesi llogaritet si detyrim mujor dhe shprehet ne meter katror siperfaqe publike te zene.

Taksa e tabelës ndahet sipas qellimit te tabelës ne: tabela per bizneset per qellime identifikimi, te trupezuar ne siperfaqen e ndertesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitetin, dhe kur nuk perdoret per te reklamuar aktivitetin e te treteve dhe tabela per qellime reklamimi, te thjeshta dhe elektronike.

Te ardhura jotatimore nga tarifat vendore, siç jane tarifat e pastrimit, ndriçimit, gjelberimit vilen ne baze te ligjit 8652, dt. 31. 07. 2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", dhe paguhen nga bizneset, institucionet e familjaret. Bashkia krijon te ardhura nga tarifat vendore per sherbimet publike qe ofron, si pastrim, gjelberim, ndriçim, duke u orientuar ne pergjithesi ne perafrimin e kosos se tyre.

Te ardhura te tjera jotatimore, siç jane te ardhura nga veprimtarite ekonomike, te ardhura nga shitja e pasurive kapitale te njesise vendore te lejuara me ligj, te ardhura nga qerate mbi trojet, ndertesat dhe objektet e tjera vendore, te ardhura nga kontribute dhe sponsorizime te ndryshme, si ndihma, dhurime, sponsorizime, te ardhurat nga gjobat dhe kundravajtjet administrative", si dhe nga te ardhura te tjera.

Te ardhura nga institucione varesie te njesive te qeverisjes vendore, ku bejne pjese pagesat per çerdhet, pagesat per kopshtet, pagesat e nxenesve te shkollave te mesme, pagesat nga konviktor me burse, gjysme-burse si dhe te ardhura te tjera nga institucione vendore.

Te ardhurat e veta sigurojne burime financiare dhe luajne nje rol te madh ne funksion te realizimit te misioneve te shumta te Bashkise ndaj qytetareve te saj, misione qe i ngarkohen me ligjin Nr. 8652 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore".

Bashkia Shkoder grumbullon te ardhura nepermjet funksionimit te administrates se saj, por gjithashtu duke u mbeshtetur edhe nga agjente tatimore si Nd/Ujsjelles Kanalizime per taksat dhe tarifat familjare, Zyra e Rregjistrimit te Pasurive te Paluajtshme per taksen e kalimit te drejtes se pronesise, Drejtoria Sherbimit te Transportit Rrugor per nje pjese te takses se rregjistrimit te pervitshem te mjeteve, Drejtoria Rajonale Tatimeve per tatimin e thjeshtuar te biznesit te vogel.



Nd/ Ujesjelles Kanalizime ne rolin e agjentit tatimor do vazhdoje te administroje bashke me tarifat per sherbimin e ujit edhe taksat dhe tarifat familjare. Arketimet per taksat dhe tarifat familjare parashikohet te ruajne edhe kete vit tendencen ne rritje, kryesisht nepermjet sensibilizimit te metjeshem te taksapaguesve familjare, nepermjet mediave dhe kontakteve direkte. Gjithashtu parashikohet shtrirja ne skemen e pageses nepermjet kontakteve nga afer me institucionet, kryesisht ato shteterore per shlyerjen nga punonjesit buxhetore te ketij detyrimi, e me tej ne ndjekjen e masave detyruese ligjore.

Te ardhurat kryesore qe administron bashkia Shkoder jane te ardhurat nga biznesi i madh, i vogel, Sh. a. O. J. F., Institucionet etj. qe likuidojne tarifat e pastrimit, ndricimit, gjelberimit, taksen e ndertesës, taksen e tabelës dhe taksa te tjera nese shfrytezojne hapësirat publike te bashkise Shkoder, si dhe taksa e ndikimit ne infrastrukture per ndertimet e reja. Planifikimi eshte bere duke u bazuar ne gjendjen aktuale te bizneseve. Pesha e te ardhurave nga biznesi i madh dhe atij te vogel ka ruajtur raportet e viteve te meperparshme, duke qene konstante ne elementet kryesore. Ngarkesa ne total e te ardhurave kryesore nga biznesi eshte 109. 500 mije Leke, ndersa raportit i ndarjes ndermjet biznesit sipas llojit eshte 57% nga biznesi i vogel dhe 43% nga biznesi i madh. Meqe biznesi i vogel eshte me i madh ne numer, rreth 77% biznese te vogla krahasuar me 23% biznese te medha, dhe pjesa me e madhe shpenzimeve nga tarifa vjen nga kjo kategori, atehere edhe te ardhurat qe gjenerohen nga tarifat jane orientuar qe te anoje sipas numrit te bizneseve, duke i dhene keshtu peshen dhe rendesine qe i takon. Ky raport i ngarkeses ka ruajtur shtrirjen e njetrajtshme dhe te konsoliduar te ngarkeses per seicilin grup biznesi nder vite. Megjithate, per te ruajtur incentiven dhe klimen e favorshme te biznesit kryesisht per bizneset e vogla qe jane motor dhe promotor i ekonomise, ngarkesa eshte mbajtur ne nivele motivuese dhe llogaritet qe mesatarja e ngarkeses per nje njesi biznes i vogel eshte 26% e totalit, krahasuar me mesataren e ngarkeses prej 74% per njesi biznes i madh.


## Struktura e biznesit ne baze te xhirove dhe kategorive, Planifikimi per vitin 2015 ( / 000 )

Ndarja e bizneseve	Subjekte	Takse Tabele	Takse ndertese	Tarife gjelberim	Tarife ndriçimi	Tarife pastrimi
<b>Biznesi i vogel</b>						
TREGTI	1,350	163	13,300	2,700	4,000	13,500
SHERBIME	500	61	4,800	1,000	1,500	5,000
PRODHIM	100	13	600	200	300	1,500
PROFESIONE TE LIRA	200	25	1,400	400	600	2,000
Transport	100	13		200	300	1,000
Zdralaj	200	25	400	400	600	2,000
Ambulant (Merkato,etj)	100					500
<b>Biznesi i vogel</b>	<b>2,550</b>	<b>300</b>	<b>20,500</b>	<b>4,900</b>	<b>7,300</b>	<b>25,500</b>
<b>Biznesi i Madh dhe Institucionet</b>						
FIRMA NDERTIMI	50	7	200	750	300	3,500
PRODHIM	70	10	5,400	350	420	4,200
TREGTI	340	45	4,200	1,690	2,080	10,220
SHERBIM	180	24	4,500	900	1,080	5,400
- Shkolle, Internet, Artizanale. Agjensi, Banka etj.	0		300			
KARBURANTE	20	3	200	140	140	900
OJF	50	7	500	120	130	150
INST.SHTETERORE	20	2		50	50	30
INST.SHTETERORE	20	2				
<b>Biznesi i madh</b>	<b>750</b>	<b>100</b>	<b>15,300</b>	<b>4,000</b>	<b>4,200</b>	<b>24,400</b>
Te ardhura tarifa e sherbimit per ndikimin ne infrastrukture						3,000
<b>TOTALI</b>	<b>3,300</b>	<b>400</b>	<b>35,800</b>	<b>8,900</b>	<b>11,500</b>	<b>52,900</b>


Ne menyre me te detajuar si me poshte raporti ndermjet biznesit te madh dhe te vogel, i tarifave kryesore qe grumbullohen nga bizneset, dhe raporti i peshes specifike sipas llojit te aktivitetit.




Te ardhura nga taska e ndertes




Te ardhura nga tarifa e pastrimit



Te ardhura nga tarifa e ndricimit




Te ardhura nga tarifa e gjelberimit



Te ardhurat jane parashikuar me rritje ne zerat kryesor krahasuar me realizimin e vitit te kaluar, ne total me nje rritje prej 9% nga taksat vendore, rritje prej 4% per tarifat e pastrimit, ndricimit, gjelberimit dhe parkimit, si dhe ka ruajtur nivelet e vitit te kaluar per te ardhurat e tjera jotatimore.

Pesha kryesore sipas kategorive eshte ngarkuar tek te ardhurat nga taksat dhe nga tarifat vendore.



Burimet kryesore nga te ardhurat nga bizneset jane planifikuar ne shtrirjen e bazes taksapaguese, rritjen e konkurrences se ndershme, ne ruajtjen e nje klime te mire biznesi nepermjet politikave te taksave konstante dhe te nderhyrjeve mbeshtetese dhe zhvilluese te biznesit, uljen e evazionit e numrit te debitoreve, rritjen e sensibilizimit te biznesit per perfshirjen ne skemen e tatimpaguesve te rregullt, rritjen e ndergjegjesimit ne njohjen dhe zbatimin e ligjit, perqendrimin e administrates se bashkise ne detyrat e veta, si dhe

bashkepunimin e mire ndersektorial dhe institucional brenda drejtorive te bashkise si dhe jashte saj me institucione te tjera te perfshira.

**PLANI I TE ARDHURAVE PER VITIN 2015**

KATEGORITE E	Planifikimi Viti 2015
<b>TE ARDHURAT E VETA GJITHSEJ</b>	<b>370,140</b>
<b>TE ARDHURAT NGA TAKSA VENDORE</b>	<b>185,900</b>
Tatim fitim i thjeshtuar biznes i vogel	52,600
Taksa e Pasurise se paluajtshme (ndertesa)	48,800
<i>nga biznesi</i>	35,800
<i>nga familje</i>	13,000
Taksa fjetjes ne hotel	900
Taksa ndikimit ne infrastrukture	40,000
Taksa kalimit drejtes pronesise	10,000
Taksa e rregjis pervitshem mjete transp	26,000
Takse zenie hapësira publike	1,000
Takse tabele	400
Taksa reklame	6,200
<b>TE ARDHURA NGA TARIFA VENDORE</b>	<b>162,340</b>
Tarife vjetore per pastrimin,heqje mbeturina	83,900
<i>nga biznesi</i>	52,900
<i>nga familje</i>	31,000
Tarife ndriçimi	23,400
<i>nga biznesi</i>	11,500
<i>nga familje</i>	11,900
Tarife gjelberimi	15,700
<i>nga biznesi</i>	8,900
<i>nga familje</i>	6,800
Tarife per leje sherbimi veterinar	200
Tarife sherbimi parkim automjete	2,300
<i>nga mjetet per biznes</i>	800
<i>parking i rezervuar</i>	1,500
Tarife licensa transporti	700
Tarife per license karburanti	300
Tarife per Legalizim,Urbanizim	33,000
Tarife sherbimi dublikate arkivi	40
Tarife sherbimi nga Instituc kult & sport	2,800
<i>Muzeu Historik</i>	2,000
<i>Taetri Migjeni</i>	600
<i>Qendra Kulturore Femijeve</i>	100
<i>Pallati Sportit</i>	100
<b>TE ARDHURA JOTATIMORE</b>	<b>21,900</b>
<i>qera lokali</i>	2,700
Te ardhura nga gjendja civile	200
Te ardhura nga bursa (shkollat)	500
Te ardhura nga kopshtet	7,200
Te ardhura nga cerdhet	4,000
Te ardhura nga kundrvajtje administrative	7,300
<i>gjobe per mosshlyerje detyrimi ne afate ligjore</i>	3,000
<i>gjobe nga kontrolle dhe inspektime</i>	300
<i>gjoba Policia bashkiake</i>	1,000
<i>gjoba nga Inspektoriati Ndertimit Vendor</i>	3,000

### 1.1. TE ARDHURA NGA BURIME KOMBETARE

Njesite e qeverisjes vendore financohen nga keto burime kombetare:

#### 1. Transferta e Pakushtezuar nga Buxheti i Shtetit.

Transferta e pakushtezuar nga buxheti i shtetit eshte e ardhur per njesite e qeverisjes vendore, e perfituar ne formen e dhurimit pa kusht kthimi, pa interes, e cila perdoret per financimin e shpenzimeve per funksionet e veta dhe te perbashketa te njesive te qeverisjes vendore, te percaktuara ne ligjin Nr. 8652, date 31. 07. 2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", si dhe per arritjen e barazise se burimeve mes njesive te ndryshme te qeverisjes vendore ne raport me mundesite e tyre per te krijuar te ardhurat e nevojshme.

Me transferimin e taksave ne njesite e qeverisjes vendore, ne formule u vendos edhe elementi ekualizues per rregullimin e transfertes per njesite e qeverisjes vendore ne pershtatje me kapacitetet fiskale te tyre.

#### Formula e shperndarjes se transfertes se pakushtezuar per vitin 2015 bazohet ne:

- a. *Te dhenat e popullsise per vitin 2015, jane marre nga "Regjistri themeltar i shtetasve" nga Gjendja Civile, e konkretisht te dhenat per muajin Korrik 2014.*
- b. *Ne transfertin e pakushtezuar jane perfshire:*
  - *Fonde per administrimin e konvikteve te arsimit parauniversitar.*
  - *Fonde per administrimin e kater qendrave te sherbimit te kujdesit social.*
- c. *Niveli minimal per fryme, per vitin 2015 do te jete:*
  - *per bashkite, 2, 960leke/fryme,*
  - *per komunat 2, 200 leke/fryme.*

Ne vitin 2015, konstatohet nje ndryshim ne lidhje me transfertin e qeverisjes vendore e cila kushtezohet nga disa elemente shtese si: 1) reforma territoriale dhe periudha e tranzicionit, deri ne hyrjen ne fuqi te ndarjes se re administrative, 2) politikat e kufizimit te shpenzimeve te ndjekura nga qeveria ne kuader te detyrimeve qe rrjedhin nga marreveshja me Fondin Monetar Nderkombetar

Transferta e pakushtezuar per vitin 2015 per Bashkine Shkoder eshte 431 578 *mije leke*.

#### 2. Transferta te Kushtezuara nga Buxheti i Shtetit

Transferta e kushtezuara ne buxhetin e vitit 2015, jepet per financimin e shpenzimeve per funksionet e perbashketa dhe per financimin e shpenzimeve per funksionet e deleguara. Keto fonde do te perdoren nga njesite e qeverisjes vendore vetem per qellimin per te cilin jane dhene dhe ne perputhje me rregullat e caktuara nga pushteti qendror. Njesite e qeverisjes vendore nuk mund ti perdorin per qellime te tjera, pervec atyre te percaktuara.

Per buxhetin e vitit 2015 transferta e kushtezuar qe do akordohet per Bashkine Shkoder do konfirmohet nga Ministrite e linjes gjate vitit 2015.

Ne fondet e kushtezuara per funksionet e perbashketa perfshihen:

- **Transfertat e Kushtezuara per funksionet e perbashketa.**

- **Fondet per zhvillimin e rajoneve.** Ne baze te Aneksit nr. 3 te ligjit “Per buxhetin e vitit 2015”, per shperndarjen e fondeve te rajoneve ngrihet komiteti vleresimit dhe miratimit te projekteve.

Aplikimi per fonde behet nga njesite e qeverisjes vendore, duke i derguar projektet ne:

- Fondin Shqiptar te Zhvillimit per objektet e infrastruktures vendore.
- Ministrine e Arsimit dhe Sporteve per objektet arsimore.
- Ministrine e Shendetesise per objektet shendetesore.
- Ministrine e Transportit dhe Telekomunikacionit per objektet e ujesjelles kanalizimeve.
- Ministrine e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit per objektet ndertim tregjesh agro-ushqimore, thertoresh dhe objekte per ujitje/kullim.
- Ministrine e Turizmit dhe Kultures per objektet kulturore.
- Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave.

#### **Fondi per Zhvillimin e Rajoneve perbehet nga:**

- *Granti konkurrues per infrastrukturen vendore*
- *Granti konkurrues per arsimin baze parauniversitar dhe universitar*
- *Granti konkurrues per shendetesine*
- *Granti konkurrues per objektet kulturore*
- *Granti konkurrues per ujesjelles kanalizime*
- *Granti konkurrues per ndertim tregjesh agro-ushqimore dhe thertoresh*
- *Granti konkurrues per Ujitjen dhe Kullimin*
- *Granti konkurrues per Pyllezimet*

- **Arsimi parauniversitar**

*Investimi:* Ne buxhetin e Ministrise se Arsimit dhe Sporteve per vitin 2015, jane te planifikuar fondet per investime per arsimin parauniversitar ne Fondin per Zhvillimin e Rajoneve. Njesite e qeverisjes vendore do te perfitojne keto fonde nepermjet paraqitjes se projekteve prane Ministrise se Arsimit dhe Sporteve dhe te vleresimit te tyre nga Komiteti i Zhvillimit te Rajoneve krijuar per kete qellim, nepermjet konkurrimit, Njesite e qeverisjes vendore mund te financojne edhe nga te ardhurat e veta ne arsimin.

- **Transfertat e Kushtezuara per Funkcionet e Deleguara**

Fonde per Ndhimen Ekonomike per Pagesen e Personave me Aftesi te Kufizuar dhe per Perkujdesjen Shoqerore.

Fondet e kushtezuara per ndihmen ekonomike, pagesen e personave me aftesi te kufizuar dhe perkujdesjen shoqerore, jane fonde te Ministrise e Mireqenies Sociale dhe Rinise pra perfshihen ne buxhetin e kesaj Ministrie. Ato ju delegohen njesive te qeverisjes vendore te cilat bejne vleresimin e nevojave si dhe kryejne pagesat e ndihmen ekonomike, te personave me aftesi te kufizuar dhe per perkujdesjen shoqerore. Per buxhetin e vitit 2015 transfertat e kushtezuar qe do akordohet per Bashkine Shkoder do konfirmohet nga Ministrite e linjes gjate vitit 2015.

**KAPITULLI SHPENZIMEVE**

Shpenzimet e njesive te qeverisjes vendore ndahen ne:

**II.1. SHPENZIME PER FUNKSIONET E VETA (EKSKLUZIVE)****II.2. SHPENZIMET PER FUNKSIONET E PERBASHKETA****II.3. SHPENZIME PER FUNKSIONET E DELEGUARA**

*Funksionet e veta*, perfaqesojne funksionet qe jane pergjegjesi ekskluzive e vete njesive te qeverisjes vendore.

*Financimi i tyre behet nga te ardhurat e veta te njesive te qeverisjes vendore dhe nga transfertat e pakushtezuara te buxhetit te shtetit.*

Ne shpenzimet per funksionet e veta perfshihen:

- *Te gjitha shpenzimet per administraten vendore duke perfshire pagat, kontributin e sigurimeve shoqerore, shpenzimet operative dhe investime.*
- *Te gjitha shpenzimet per sherbimet publike si: pastrim, gjelberim, dekor, funeral, ndricim qyteti etj. duke perfshire kosto te personelit, shpenzime operative dhe investime.*
- *Te gjitha shpenzimet per institucionet vendore te kultures dhe sportit (me perjashtim te shpenzimeve per cilesine sportive, ku Ministria e Turizmit dhe Kultures, mbulon me grantin e saj, financimin e sportistev e trajnereve cilesore.*
- *Te gjitha shpenzimet per mirembajtjen dhe ndertimin e rrugeve vendore duke perfshire kosto te personelit, shpenzime operative dhe investime.*
- *Shpenzimet per transportin urban.*

**II. 2 SHPENZIMET PER FUNKSIONET E PERBASHKETA**

*Funksionet e perbashketa*, lidhen me ato fusha te veprimtarise qe jane pergjegjesi e perbashket e qeverisjes qendrore dhe njesive te qeverisjes vendore, pergjegjesi kjo e ndare qarte per secilin nivel.

Shpenzimet per kryerjen e funksioneve te perbashketa perballohen nga:

- *Transferta e pakushtezuar e buxhetit te shtetit per njesite e qeverisjes vendore.*
- *Te ardhurat e veta te njesive te qeverisjes vendore.*
- *Grantet konkurruese (fondet e zhvillimit rajonal) per investime ne arsimin parauniversitar.*
- *Grantet konkurruese (fondet e zhvillimit rajonal) per investime ne kujdesin paresor shendetesor dhe mbrojtjen e shendetit publik.*

**➤ Arsimin:**

Mirembajtjen dhe funksionimin e shkollave te cilat financohen nga burimet e veta vendore. Keto shpenzime miratohen ne buxhetin e pavarur te njesive vendore.

Investime ne arsimin parauniversitar, te perfituara nga njesite e qeverisjes vendore nga granti konkurrues per arsimin. Keto shpenzime miratohen ne buxhetin e kushtezuar te njesive vendore.

Njesite e qeverisjes vendore mund te financojne nga te ardhurat e veta per ndertim, rikonstruksion dhe pajisje te kopshteve dhe shkollave te arsimit parauniversitar dhe nekete rast shpenzimet miratohen ne buxhetin e pavarur te njesive vendore.

*Shpenzimet per trajtimin ushqimor te nxenesve bursiste, konviktove perballohen nga fondet buxhetore, te miratuara per Ministrine e Arsimit dhe Shkences.*

## **II. 3 SHPENZIME VENDORE PER FUNKSIONET E DELEGUARA.**

Ne shpenzimet vendore per funksionet e deleguara perfshihen:

### **Shpenzimet per mbrojtjen sociale**

Ministria e Mireqenies Sociale dhe Rinise detajon ne fillim te vitit 2015, fondet e ndihmes ekonomike dhe pagesen e paafesise. Keto fonde i delegohen çdo njesie te qeverisjes vendore qe ne fillim te vitit.

### **Shpenzimet per perkujdesjen shoqerore**

Financimi i sherbimeve te perkujdeset shoqeror, qe realizohen nga bashkite komunat dhe qarqet, do te behen nga buxheti i shtetit, si dhe te ardhurat vendore. Fondet nga buxheti jepen ne formen e grantit te kushtezuar nga Ministria e Mireqenies Sociale dhe Rinise qe ne fillim te vitit,

- Bashkite dhe komunat administrojne sherbimet e perkujdesjen shoqerore per qendra te perkujdeset qe u sherbejne individeve, banore te bashkise ose komunes si dhe sherbimet e perkujdeset per keta individe.

Shpenzimet per kete qellim qe perballohen me fonde te kushtezuara nga buxheti i shtetit perfshihen ne buxhetin e kushtezuar te njesive te qeverisjes vendore.

## **III. SHPENZIMET QE KRYHEN NGA NJESITE E QEVERISJES VENDORE PER LLOGARI TE PUSHTETIT QENDROR, POR QE NUK JANE SHPENZIME VENDORE DHE NUK MIRATOHEN NE BUXHETIN VENDOR NGA KESHILLI PERKATES.**

- **Shpenzimet per paga, sigurime shoqerore e shendetesore per QKR.**
- **Shpenzimet per paga, sigurime shoqerore dhe shendetesore per kryerjen e sherbimit te gjendjes civile.**

## **DISA ELEMENTE TE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

### **• Paga dhe shtesat mbi paga (Artikulli 600)**

Ketu perfshihen shpenzimet per pagen baze dhe shtesat mbi page. Numri i punonjesve per administraten e njesise se qeverisjes vendore dhe per personelin e ndermarrjeve ne varesi te njesise se qeverisjes vendore percaktohet nga keshilli perkates i njesise. Paga baze sipas klasave dhe shtesat mbi page do te perllogariten ne baze te V. K. M Nr. 586 date 17. 7. 2013 Per disa ndryshime ne vendimin 1619 date 2. 7. 2008 te Keshillit te Ministrave “Per

klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njesive te qeverisjes vendore, per efekt page e per caktimin e kufijve te pagave te punonjesve te organeve te qeverisjes vendore".

Perlllogaritja e Fondit te Veçante dhe perdorimi i tij, behet sipas Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 929 Date 17. 11. 2010 « Mbi krijimin dhe perdorimin e fondit te vecante nga njesite e qeverisjes se pergjithshme" ndryshuar me VKM 493 date 63. 7. 2011, VKM nr. 826 date 5. 12. 2011, VKM 949 date 6. 12. 2012. Per kompensimet, do te zbatohet V. K. M Nr. 499, date 13. 08. 1998, ndryshuar me V. K. M Nr. 683, date 28. 10. 1998.

Sipas VKM Nr. 1619, date 2. 7. 2008 te ndryshuar keshillat e njesive te qeverisjes vendore miratojne shperblimin mujor te keshilltareve dhe kryetareve te fshatrave ne masen deri ne 10 per qind te pages, perkatesisht, te kryetarit te keshillit te qarkut, kryetarit te bashkise, kryetarit te njesise bashkiake dhe atij te komunes.

Bazuar ne ligjin nr. 160/2014 date 27. 11. 2014 " Per buxhetin e vitit 2015" neni 15: " Bashkite, qe kane mbi 50 001 banore, perdorin deri ne 10 per qind te transfertes se pakushtezuar per koston e personelit administrativ ".

• **Kontributi per sigurime shoqerore dhe shendetesore(Artikulli 601)**

Kontributi i sigurimeve shoqerore dhe shendetesore ne zbatim te ligjit 10070 date 5. 2. 2009 "Per disa ndryshime te ligjit Nr. 7703, date 11. 05. 1993, "Per sigurimet shoqerore ne Republiken e Shqiperise", ndryshuar dhe te ligjit Nr. 7870, date 13. 10. 1994 "Per sigurimet shendetesore ne Republiken e Shqiperise", te ndryshuar", do te jete nga punedhenesi perkatesisht 16. 7 % dhe nga punemarresi 11. 2 %.

Ne baze te VKM nr. 581 date 17. 7. 2013 qe ka ndryshuar VKM 1114 date 30. 7. 2008 fondi i pagave mbi te cilin llogaritet kontributi i sigurimeve shoqerore dhe shendetesore behet sipas: Paga minimale mujore, per efekt te llogaritjes se kontributit te sigurimeve shoqerore e shendetesore eshte 22 000 leke, ndersa paga maksimale 97 030 leke.

Ndersa ne baze te vkm 573 date 3. 07. 2013 paga minimale eshte 22 000 leke.

**a. Planifikimi per mallra dhe sherbime te tjera (Artikulli 602)**

Planifikimi i shpenzimeve per "Mallra dhe sherbime te tjera" (shpenzime operative) per vitin 2015, do behet sipas ndarjes ne nenartikuj sipas klasifikimit ekonomik per çdo funksion ne veçanti. Per secilin nga zerat e perfshire ne kete artikull planifikimi i nevojave duhet te mbeshtetet ne normativa sa me te drejta te vendosura nga bashkite dhe komunitat.

**b. Planifikimi per investime (231)**

Investimet perballohen nga te ardhurat e veta te njesive te qeverisjes vendore, transfertat e pakushtezuar, si dhe nga buxheti i shtetit. Te gjitha fondet per investime do te menaxhohen sipas procedurave te percaktuara ne:

- Ligjin Nr. 9643, date 20. 11. 2006, "Per prokurimin publik"i ndryshuar
- Ligjin Nr. 8652, date 31. 07. 2000, "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" i ndryshuar
- K. M Nr. 914, date 29. 12. 2014, "Rregullat e prokurimit publik" etj.

**2. Fondet e investimeve (230, 231) nga grandet prej fondeve te zhvillimit rajonal.**

Procedurat e prokurimit te ketyre fondeve kryhen mbi bazen ligjore te cilesuar me lart. Keto procedura fillojne pas marrjes se shkrases nga Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Ministria e Shendetesise dhe Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe

Telekomunikacionit per akordim fondi sipas destinacionit te percaktuar. Te gjitha fondet per investime nga granti konkurrues te cilat akordohen nga Ministria e Brendshme prokurohen drejtperdrejt nga njesia vendore pavaresisht nga vlera.

### 3. Fonde te tjera per investime

Per fonde te tjera per investime (me burim financimi te ndryshem) qe miratohen nga Ministria e Brendshme do te zbatohet V. K. M Nr. 914, date 29. 12. 2014, "Rregullat e prokurimit publik" etj.

### 4. Investimet qe kryhen ne njesite e qeverisjes vendore

Fondet per investime qe kryhen ne njesite e qeverisjes vendore kane si burim financimi te ardhurat e tyre dhe transfertet e pakushtezuar.

#### ➤ Per Fondin e Kontigjences

Bazuar ne Nenin nr. 19/7. a. iii te ligjit nr. 8652 date 31. 07. 2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" dhe nenit 6 te ligjit nr. 9936, date 26. 06. 2008, Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise", per te perballuar shpenzime te paparashikuara ne buxhetin e njesive te qeverisjes vendore, krijohet Fondi Rezerve. Per te perballuar efektet e mosrealizimit te te ardhurave, nevojten e kryerjes se financimeve te reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara, te programeve ekzistuese krijohet Fondi i Kontigjences. Te dy keto fonde miratohen ne masen deri ne 3 (tre) per qind te vleres se pergjithshme te fondeve te miratuara, duke perjashtuar transfertat e kushtezuara.


Per vitin 2015 eshte parashikuar nje Fond Rezerve prej **8 000 mije leke**.

#### ➤ Per Detyrimin e Keshillit te Qarkut

Ne baze te ligjit nr. 8652 date 31. 07. 2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" Neni 18 njesite e qeverisjes vendore derdhen nje kuote per llogari te Keshillit te Qarkut. Per vitin 2015 eshte llogaritur shuma prej **7 000 mije leke**.

**Tabele Permbledhese e Programeve per vitin 2015**

NR	EMERTIMI	PLANI 2015
I	Programi 6260-Sherbime Publike	246 383
II	Programi 4570-Transporti Publik	9 120
III	Programi 4530-Infrastruktura rrugore	111 979
V	Programi 6330- Ujesjelles Kanalizime Vendore	7 200
V	Programi 6140 -Urbanistike vendore	1 200
VI	Programi 8250-Kultura	66 708
VII	Programi 8140-Sporti	59 538
VIII	Programi 9240-Arsimi	75 101
IX	Programi 10140-Kujdesi Social	42 176
X	Programi 1110 - Administ. e Bashkise	174 313
XI	Programi 4980- Shpenz. te tjera	8 000
	<b>TOTALI ( I-X)</b>	<b>801 718</b>





## SHERBIMET PUBLIKE

### 1. Sherbimi i Pastrimit te Qytetit

Sherbimi pastrimit ne buxhetin 2015 do te realizohet ne vazhdim te kontrates 5-vjeçare, zbatimi i te ciles ka filluar me daten 1 Tetor 2013.

*Plani i vitit 2015, ne mije leke*

Nr	Emertimi	Plani 2015
1	Paga	1 196
2	Sigurime shoqerore	191
3	Shpenzime operative	99 245
	<b>SHUMA</b>	<b>100 632</b>

Ne kontrate sherbimet kryesore jane:

- Sherbimi mbledhje e mbeturina urbane do te realizohet ne te gjithë qytetin. Çdo dite do te grumbullohen dhe transportohen nga vend-depozitim 600 cope kazane mbetje.
- Menaxhimi i kazaneve, duke kryer larjen e tyre, riparimet e rrotave, si dhe lysterjen e tyre nga demtimet, do te realizohet cdo muaj sipas planifikimit. Gjithashtu ne kete kontrate parashikohet dhe zevendesimi me 90 kazane te rinj ne vit (54 kazane zona A dhe 36 kazane zona B) nga operatori ekonomik.
- Fshirja e rrugeve me mekanike dhe me dore do te kryhet cdo dite sipas siperfaqeve te hartuara ne grafik, ndersa pjesa tjeter e siperfaqeve te rrugeve do te mirembahet cdo dite nga punonjes te kesaj sipermarrijeje.
- Larja e rrugeve do te kryhet per 200 dite sipas grafikut te larjes se rrugeve 1 here ne dite dhe 2 here ne dite. Ky proces pune eshte llogaritur te kryhet deri ne oren 08. 00 te mengjesit dhe mbasdite pas ores 18. 00.

Ketu eshte parashikuar dhe rritja e diferences se transportit per ne Landfill, miratuar ne VKB nr 5 date 31. 01. 2014, per efektin e rritjes se distances nga 3 km ne 15 km (landfill-Bushat).

Ne baze te kontrates themelore te lidhur ne tetor te 2013 kemi:

1. Shoqeria do te paguhet ne baze te peshes se mbetjeve te depozituara ne Lanfillin Bushat.
2. Kostot e grumbullimit te mbetjeve do te reduktohen deri ne masen 3% ne perpjestim me sasine e mbetjeve te ricikluara.
3. Riciklimi eshte si detyrim i firmes sipermarrese.
4. Shoqeria do te paraqese prane Bashkise Shkoder evidencat mujore me sasite e mbetjeve te ndara per riciklim sipas llojeve.

## Pasqyra e shpenzimeve: Pastrimi i Qytetit viti 2015

Nr	Emertimi i sherbimeve	Njesi	ZONA JUGORE (A)			ZONA VERIORE (B)		
			Sasia	Çmimi	Vlera	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Mbledhja dhe grumbullimi i mbetjeve urbane ne qytet	kazana	131 400	182	23 914 800	87 600	206	18 045 600
2	Menxhim e mirembajtje kazanesh	kazana	360	1 700	612 000	240	1 800	432 000
3	Fshirje mekanike te rrugeve	m2	27 603 950	0,18	4 968 7111	27 545 230	0,2	5 509 046
4	Fshirje manuale te rrugeve	m2	24 773 361	0,18	4 459 205	22 296 025	0,2	4 459 205
5	Mirembajtje e 30% te rrugeve	km	20 075	160	3 212 000	20 075	160	3 212 000
6	Larje te rrugeve	m2	-	-	-	32 510 950	0,12	3 901 314
7	Diference transporti per ne Land-fill 15 km	Ton/km	249 480	24	5 987 520	166 320	24	3 991 680
	<b>Shuma</b>				<b>43 154 236</b>			<b>39 550 881</b>
	T V SH 20 %				<b>8 630 847</b>			<b>7 910 116</b>
	<b>TOTALI</b>				<b>51 785 083</b>			<b>47 460 697</b>
	<b>SHUMA TOTALE A + B</b>		-	-	-			<b>99 245 780</b>

**2. Landfilli – Bushat**

Vazhdon shfrytezimi i landfillit Bushat, prandaj eshte bere parashikimi per koston e depozitimit te mbetjeve urbane ne kete landfill qe ka vleren 12 839 mije lek, kjo sipas kontrates se lidhur ne 28. 08. 2014, ne vazhdimesi te akt-marreveshjes se lidhur ne tetor 2013, per fillimin e depozitimit te mbetjeve urbane ne landfillin Bushat.

